

RAPORT VJETOR | 2020

AGJENCIA SHQIPTARE E ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE (AIDA)



Adresa: Rruga "Skerdilajd Llagami", Nd.1, H.6, Tiranë.
Tel: +355 (0) 42251001, www.aida.gov.al | e-mail: info@aida.gov.al

RAPORTI VJETOR 2020

1

Mesazh i Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s

2

Profili i AIDA-s

3

AIDA në ushtrim të funksioneve të veta

4

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë

5

AIDA në aktivitete

6

Koordinimi i AIDA-s

7

AIDA në përmbushje të transparencës
dhe rritjes së imazhit ndërinstitucional

8

Shqipëria në EXPO 2020 DUBAI

1 MESAZH I DREJTORIT EKZEKUTIV



Z. Sokol NANO
Drejt看 Ekzekutiv

“Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) konsiderohet si pikë kyçe në nxitjen dhe mbështetjen e investimeve të huaja direkte në vend, si promotore e zhvillimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe si një entitet i fortë stimulues për produktet ‘Made in Albania’.

Viti 2020, për AIDA-n ishte një vit sa i suksesshëm, aq dhe i vështirë dhe me sfida organizative për shkak të pandemisë globale duke ndikuar në mënyrë të pashmangshme në aktivitetet dhe fokusin e agjencisë.

Në përgjigje të situatës COVID-19, AIDA ka treguar proaktivitet në mbështetjen e bizneseve vendase dhe investorëve të huaj duke shërbyer si një urë lidhëse ndërmjet qeverisë, sektorit publik dhe sipërmarrësve.

AIDA, përgjatë vitit 2020 i ka arritur objektivat duke dhënë kontribut në mbështetje të biznesit vendas dhe investorëve nëpërmjet informimit të vazhdueshëm mbi zhvillimet e COVID-19, aksesit në programet dhe skemat mbështetëse të qeverisë, përdorimit të mjeteve dhe platformave ndërvepruese digjitale.

Me besimin se viti 2021, do të jetë një vit edhe më i suksesshëm dhe i frytshëm, AIDA do të vazhdojë t’i përgjigjet nevojave të biznesit vendas për ta bërë atë më konkurrues në tregun vendas dhe në veçanti në tregun e huaj e për t’ju përshtatur edhe më mirë së ardhmes.

AIDA mbetet e angazhuar në shërbimet efektive ndaj investorëve ekzistues, tërheqjen e investimeve të huaja duke promovuar sektorë strategjikë e mundësi investimesh, si edhe promovimin e Shqipërisë si një destinacion strategjik.

Me kontributin, dinamikën, profesionalizimin dhe ekspertizën e stafit, sot AIDA është e konfirmuar si struktura administrative kompetente për dhënien e shërbimeve në një “dritare unike” për investorët dhe projektet.

Suksesi i AIDA-s, në përmbushjen e misionit të saj, lidhet ngushtë me konsolidimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me agjencitë homologe, organizatat dhe institucionet lokale e qendrore.

AIDA është mbështetja që ju duhet në vendimin tuaj për të investuar, për të zhvilluar biznesin tuaj dhe për të konkurruar në treg.”

2 PROFILI I AIDA-S

2.1. Misioni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve ka për mision të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit privat, të forcojë potencialin eksportues të vendit, të promovojë mbështetjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta në Shqipëri, si dhe të promovojë potencialin turistik të vendit. AIDA, maksimizon investimet e brendshme dhe të huaja, nëpërmjet krijimit të iniciativave ndihmuese rrit aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve në Shqipëri, përmirëson kapacitetet teknologjike dhe rinovimin e tyre me qëllimet e kombinuara që të rris investimet e huaja direkte, të forcojë kapacitetet e biznesit shqiptar, si edhe të ndërtojë një imazh të denjë të Shqipërisë me fokus tërheqjen e investitorëve të ndryshëm.

2.2. Funksionet kryesore të AIDA-s

Veprimtaria e Agjencisë përqendrohet, kryesisht, në:

- lehtësimin dhe mbështetjen e investimeve të drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë;
- rritjen e aftësisë konkurruese dhe inovative të ndërmarrjeve të vogla e të mesme;
- nxitjen dhe ndihmën ndaj eksporteve të mallrave e të shërbimeve;
- nxitjen dhe tërheqjen e investimeve strategjike, vendase dhe të huaja.

Agjencia ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe duke ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si edhe duke ndërmjetësuar e duke bashkëpunuar me investitorët e organet shtetërore.

2.3. Kuadri ligjor i Agjencisë

AIDA funksionon në bazë të kuadrit ligjor të posaçëm:

- Ligjit nr. 10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”,
- Statutit të AIDA-s, miratuar me Vendim të Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 2, datë 04.01.2011, të ndryshuar me vendimin nr. 1, datë 25.03.2019,
- Rregullores së Brendshme të AIDA-s, miratuar me vendimin e Bordit Drejtues të AIDA-s nr. 11, datë 21.07.2011;
- Vendimit nr. 3, datë 17.06.2019 “Për miratimin e nivelit të pagave dhe të strukturës e organikës së Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA).

Aktualisht, AIDA strukturohet në pesë drejtori:

1. Drejtoria e Investimeve


2. Drejtoria e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme dhe Projekteve

3. Drejtoria e Marketing & Kërkim Analizë

4. Drejtoria e Koordinimit

5. Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse

2.4. Organigrama



Drejtoria e Investimeve ka këto funksione:

- a) Asiston dhe mbështet investimet e drejtpërdrejta në Republikën e Shqipërisë, nëpërmjet identifikimit e promovimit të mundësive për investime;
- b) Ofron shërbimin e përkujdesjes dhe mbështetjes së investitorëve ekzistues ose potencialë;
- c) Asiston dhe mbështet me procedura të përshpejtuara investimet strategjike në Republikën e Shqipërisë.

Drejtoria e NVM dhe Projekte ka këto funksione:

- a) Të rrisë aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare për zhvillimin e tyre;
- b) Të jetë në shërbim të sipërmarrësve shqiptarë dhe partnerëve të huaj që dëshirojnë të hyjnë në partneritet me kompani shqiptare nëpërmjet shërbimeve kryesore siç është dhënia e granteve të shtetit shqiptar apo identifikimi i tregjeve ose partnerëve të rinj për eksport, nevojat për trajnim dhe për certifikim produkti, lehtësimin e pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare etj, mbështetje nëpërmjet projekteve të ndryshme me donatorë.

Drejtoria Marketing & Kërkim Analizë ka këto funksione:

- a) Sigurimin e komunikimit dhe marketingut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj.;
- b) Kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik.

Drejtoria e Koordinimit ka këto funksione:

- a) Mbajtjen dhe koordinimin e marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me departamentet brenda AIDA-s;
- b) Matjen dhe vlerësimin e rezultateve të performancës së institucionit me qëllim orientimin e politikave dhe burimeve.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka këto funksione:

- a) Të mbështesë veprimtarinë e Agjencisë, duke zbatuar legjislacionin në fuqi, me qëllim krijimin e infrastrukturës dhe burimet e domosdoshme që garantojnë zhvillimin e veprimtarisë normale të proceseve të punës;
- b) Të ndjekë të gjithë aktivitetin ekonomik - financiar dhe administrativ të institucionit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

3 AIDA NË USHTRIM TË FUNKSIONEVE TË VETA

3.1. Hyrje

AIDA, ju ndihmon të investoni në Shqipëri duke ju mbështetur me:

Informacione mbi mundësitë e investimit në Shqipëri dhe arsyet kryesore përse vendi ynë është tërheqës për Investimet e Huaja Direkte. Të gjithë informacionin rreth ekonomisë së Shqipërisë, burimet njerëzore, infrastrukturës, stimujve investues prezantohen në një shkallë të gjerë me dokumente në shqip dhe anglisht;

Kontakte nga Shqipëria apo jashtë saj, falë një pune paraprake anketimi dhe misionëve specifikë të kontaktit për të përmbushur nevojat e investorëve. Qasja jonë është të paraqesim ofertën më të kënaqshme shqiptare për kompanitë që kërkojnë ndërkombëtarizim;

Këshilla për mjedisin e përshtatshëm për suksesin e projekteve, rajoneve të funksionimit, planeve të investimeve, metodave të financimit;

Ndihmë për investorët me vizitat eksploruese në Shqipëri dhe në fazat e ndryshme të zbatimit të projektit. Programet e kontaktit me institucionet dhe kompanitë shqiptare në fushat e aktiviteteve të dëshiruara dhe interesave të investorëve, të cilat përgatiten nga stafi i AIDA-s;

Mbështetje për të përmirësuar qëndrueshmërinë e kompanisë përmes monitorimit të personalizuar dhe ndihmës së vazhdueshme me departamentet e ndryshme ministrore shqiptare, si dhe me organizatat dhe autoritetet rajonale.

3.2. Investimet


3.2.1 Investimet e huaja direkte në Shqipëri (IHD)

3.2.1.1. Krahësim i vitit 2019 – 2020 në terma të fluksit dhe stokut të IHD-ve

Referuar të dhënave nga Banka e Shqipërisë për vitin 2020, indikator i fluksit shënon vlerën 933 milionë euro, 13% më e ulët krahasuar me një vit më parë, ndërsa stoku shënon vlerën 8,819 milionë euro. Krahasuar me vitin 2019, kemi një rritje me 671 milionë euro ose 8.2 %.

3.2.1.2 Vështrim krahasues i Fluksit dhe Stokut për periudhën 2015 – 2020

Grafiku i mëposhtëm paraqet ecurinë e fluksit të IHD-ve përgjatë periudhës 2015 – 2020. Vërehet një tendencë e qëndrueshme dhe pozitive e vlerës së fluksit përgjatë viteve. Në vitin 2019 fluksi ka shënuar vlerën 1,073 milionë euro, më e larta nga viti 2015.




Burimi: Banka e Shqipërisë

Për vitin 2020, indikator i fluksit shënon vlerën 933 milionë euro krahasuar me vitin 2019, kemi një rënie me 140 milionë euro ose me 13%, e justifikuar kjo edhe nga situata e pandemisë COVID-19 në vend.

Nga grafiku i mëposhtëm vërejmë se stoku i IHD-ve ka patur një trend rritës përgjatë periudhës 2015 - 2020 duke shënuar vlerën më të lartë në vitin 2020.

Në vitin 2019, krahasuar me vitin paraardhës, stoku është rritur me 693 milionë euro ose me 9.3%. Kjo tendencë rritëse ka vijuar edhe në vitin 2020 ku stoku ka arritur vlerën 8,819 milionë euro, duke shënuar një rritje me 671 milionë euro ose 8.2 %.



Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2.2. Fluksi dhe Stoku i IHD-ve sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2019 dhe 2020

3.2.2.1. Fluksi sipas aktivitetit ekonomik

Lidhur me shpërndarjen e fluksit të investimeve direkte sipas aktivitetit ekonomik për vitin 2019, aktiviteti kryesor që ka zënë peshën më të madhe të fluksit ka qenë energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë me 30.95% të totalit.

Aktivitetet e tjera dominuese përgjatë vitit 2019 kanë qenë: industria nxjerrëse (20.3%); aktivitete financiare dhe të sigurimit (11.58%) dhe aktivitete të pasurive të paluajtshme (10.66%).

Gjatë vitit 2020, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve ishte energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë që përfaqësonte 27.8% të fluksit total.

Sektorë të tjerë ekonomikë me një kontribut të lartë në IHD janë sektori i industrisë nxjerrëse dhe aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 14.3%, i aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 8.7% dhe i tregtisë me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me 6.5% ndaj totalit.

Aktiviteti Ekonomik	Vlera e fluksit 2020 (mln euro)
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	260
Industria nxjerrëse	134
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	134
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	82
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	61

Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2.2.2. Stoku sipas aktivitetit ekonomik

Aktiviteti kryesor që ka patur peshën më të madhe të stokut të IHD-ve për vitin 2019 ka qenë energjia elektrike, gazi dhe furnizimi me ujë me 29.53% ndaj totalit. Aktivitete të tjera dominuese përgjatë vitit 2019 kanë qenë: industria nxjerrëse (14.21%); informacioni dhe komunikacioni (13.21%) dhe aktivitete financiare dhe të sigurimit (13.10%).

Për 2020, burimi kryesor i hyrjeve të IHD-ve ishte Energjia elektrike, gazi, dhe furnizimi me ujë që përfaqësonte 30% të stokut total. Sektorë të tjerë ekonomik me një kontribut të lartë në IHD janë sektori i Industrisë nxjerrëse me 14.2 %, Aktiviteteve financiare dhe të sigurimit me 12.8%, i Informacionit dhe Komunikacionit me 12.7% dhe i Aktiviteteve të pasurive të paluajtshme me 6.4% ndaj totalit.

Aktiviteti Ekonomik	Vlera e stokut 2020 (mln euro)
Energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar	2638
Industria nxjerrëse	1253
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	1131
Informacioni dhe komunikacioni	1127
Aktivitete të pasurive të paluajtshme	570

Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2.3. Fluksi dhe Stoku i IHD-ve sipas shteteve për vitin 2019 dhe 2020

3.2.3.1. Fluksi sipas shteteve

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për vitin 2019, investimet e huaja në vend janë kryesuar nga Holanda me 24.2% ndaj totalit të fluksit, e ndjekur nga Zvicra me 18.4%, Italia me 11.1%, Franca 6.8% dhe Turqia me 4.8%.

Për 2020, investimet e huaja në vend janë dominuar nga Holanda e cila ka kontribuar me rreth 22% në fluksin total, ndjekur nga Zvicra me 20.3%, Italia me 12.5%, Turqia me 10% dhe Austria me 7.8%

Shteti	Vlera e fluksit 2020 (mln euro)
Holandë	206
Zvicër	190
Itali	117
Turqi	94

Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2.3.2. Stoku sipas shteteve

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, për vitin 2019, investimet e huaja në vend janë kryesuar nga Zvicra me 18.3% ndaj totalit të stokut, e ndjekur nga Holanda me 15.3%, Kanadaja me 13.7%, Italia me 9.4%, Turqia me 7.4% dhe Austria me 6.7%.

I njëjti trend ka vijuar edhe përgjatë vitit 2020 ku ka vijuar të dominojë Zvicra me 18.8% ndaj stokut total, e ndjekur nga Holanda me 16.1%, Kanadaja me 12.8%, Italia me 10%, Turqia me 7.1% dhe Austria me 6.8%.

Shteti	Vlera e Stokut 2020 (Mln Euro)
Zvicër	1665
Holandë	1422
Kanada	1129
Itali	874
Turqi	633

Burimi: Banka e Shqipërisë

3.2.4. Tregtia e Jashtme

3.2.4.1. Të dhëna mbi importet

Vlera e importeve për vitin 2019 arriti vlerën e 5260 milionë euro. Peshën më të madhe në këtë indikator e përbën grupmali 'makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 21.4% ndaj totalit, i ndjekur nga grup-mali 'Ushqim, pije, duhan' me 17% si edhe nga 'Produkte kimike dhe plastike' me 13.7 %.

I njëjti tregues, gjatë vitit 2020, arriti vlerën e 4905 milionë euro, pra vihet re një rënie në masën 6.7%. Lidhur me përbërjen e strukturës së importeve, gjatë vitit 2020 ka qenë i njëjti trend me vitin paraardhës, pra peshën kryesore e ka pasur grup-mali 'makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 22.1 % ndaj totalit. Më pas vjen grup-mali 'Ushqim, pije, duhan' me 18.3% dhe 'produkte kimike dhe plastike' me 15% ndaj totalit.

Grup-mali	2019 (mln euro)	2020 (mln euro)
Ushqim, pije, duhan	894	899
Minerale, lëndë djegëse, energji. elektrike	626	442
Produkte kimike dhe plastike	719	738
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	140	102
Prodhime druri dhe letre	209	195
Tekstile dhe këpucë	707	611
Materiale ndërtimi dhe metale	636	634
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1,124	1,084
Të tjera	205	199
Totali	5,260	4,905

3.2.4.2. Të dhëna mbi eksportet

Vlera e eksporteve për vitin 2019 shënon vlerën e 2421 milionë euro. Peshën më të madhe në këtë indikator e përbën grup-mali 'tekstile dhe këpucë' me 39.6 % ndaj totalit, i ndjekur nga grupmali 'minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 16.8% si edhe 'materiale ndërtimi dhe metale' me 15.2%.

I njëjti tregues, gjatë vitit 2020, arriti vlerën e 2204 milionë euro, pra vihet re një rënie në masën 8.9%. Lidhur me përbërjen e strukturës së eksporteve, në 2020 ka qenë pothuajse i njëjti trend me vitin paraardhës, pra peshën kryesore e ka pasur grup-malli 'tekstile dhe këpucë' me 37.6% ndaj totalit. Më pas renditet grup-malli 'materiale ndërtimi dhe metale' me 15.4% si dhe 'minerale, lëndë djegëse, energji elektrike' me 14.7%.


Grup-malli	2019(mln euro)	2020(mln euro)
Ushqim, pije, duhan	287	316
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	407	323
Produkte kimike dhe plastike	62	60
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	20	15
Prodhime druri dhe letre	78	70
Tekstile dhe këpucë	958	829
Materiale ndërtimi dhe metale	368	339
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	169	181
Të tjera	73	70
Totali	2,421	2,204

3.2.5. Tregu i Punës

3.2.5.1. Indikatorë të Tregut të Punës

Forca e punës gjatë periudhës 2017-2019 ka qenë në rritje. Në vitin 2018 forca e punës ishte 1403 mijë persona, ndërsa ka arritur në 1430 mijë në 2019 me një rritje prej 3,2%.

Forca punëtore (në mijë)



Niveli i punësimit përgjatë periudhës 2017-2019 ka shfaqur gjithashtu rritje. Në vitin 2019 niveli i punësimit arriti në 1266 mijë të punësuar, duke u rritur me 2,9% nga viti paraardhës. Gjatë tremujorit të tretë 2020, në krahasim me të njëjtin tremujor të vitit 2019, numri i të punësuarve gjithsej u ul me 1,2 %, ndërkohë krahasuar me tremujorin e dytë të vitit 2020, ky tregues u rrit me 2,8 %.

Niveli i papunësisë ka pësuar një rënie prej 0.8 pikë përqindje nga viti 2018 në vitin 2019, duke arritur nivelin e 165 mijë të papunëve (për grup-moshën 15-74 vjeç). Në tremujorin e tretë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri, për popullsinë 15 vjeç e lart, është 11,6 %. Krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2019, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,2 pikë përqindje, ndërkohë krahasuar me tremujorin e dytë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë u ul me 0,3 pikë përqindje.

3.2.5.2. Punësimi sipas aktivitetit ekonomik

Për sa i përket punësimit sipas aktiviteteve ekonomike në vitin 2019, sektori i shërbimeve (shërbime të tregut dhe shërbime jo të tregut) dhe sektori bujqësor kanë përqindjen më të lartë të të punësuarve me përkatësisht 43,5 % dhe 36,4 % të të punësuarve gjithsej.


Punësimi sipas aktivitetit ekonomik (në %)

Aktiviteti ekonomik	2017	2018	2019
Bujqësi	38.2	37.4	36.4
Shërbime të tregut	25	25.7	27.2
Shërbime jo të tregut	17.4	17.2	16.3
Prodhim / Manufakturë	10.1	10.6	10.9
Ndërtim	6.9	7	7
Industri të tjera	2.4	2.2	2.2

Viti 2019 u karakterizua nga një rritje e punësimit në sektorin e shërbimeve të tregut dhe manufakturës, rritje e numrit të të punësuarve me pagë dhe ulje e numrit të të vetëpunësuarve. Tregu shqiptar i punës është ende jo mikpritës i profesioneve të lira, të cilat shpesh shndërrohen në biznese familjare me punëtore familjare të pa paguar.

3.2.5.3. Punësimi sipas statusit në punësim

Sipas vlerësimeve të anketës për vitin 2019, rezulton se 45,7 % e të punësuarve janë të punësuar me pagë, 32,3 % janë të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar pa të punësuar të tjerë) dhe 22 % janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes.



Paga minimale është nga ata indikatorë të tregut të punës me dy impakte direkte: është indikator që tërheq interesin e investitorëve të huaj, por njëkohësisht përcakton edhe standardin e investimit potencial të huaj.

Viti	2016	2017	2018	2019	2020
Paga Minimale	22,000	24,000	24,000	26,000	26,000

Paga mesatare

Në vitin 2019, paga mesatare bruto për një të punësuar me pagë në Shqipëri është 52,380 lekë. Niveli i pagës mesatare mujore bruto paraqet një tendencë në rritje. Krahasuar me vitin 2018, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar në Shqipëri u rrit me 3,5 %.

Ndërkohë, paga mesatare mujore bruto për një të punësuar me pagë, gjatë tremujorit të tretë 2020, është 52.815 lekë, duke u rritur me 1,8 %, krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit të kaluar.

Viti	2017	2018	2019
Paga mesatare mujore bruto	48,967	50,589	52,380
Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror	59,813	61,023	63,084
Paga mesatare mujore në sektorin privat	44,027	45,759	47,532

3.2.6. Lead Generation & AfterCare

3.2.6.1. Tërheqja e Investimeve

Menjëherë, pas përfundimit të suksesshëm të Outreach Campaign të bujqësisë, e cila u mbajt në maj 2019 në Zvicër, AIDA filloi përgatitjet për një fushatë të dytë që do të realizohej në vitin 2020, në përputhje me Strategjinë e Evropës Juglindore 2020 dhe Planin e veprimit shumëvjeçar për të krijuar një Zonë Ekonomike Rajonale.

Sektori automotiv u zgjodh si sektor me përparësi, duke synuar rritjen e shumëllojshmërisë së investimeve të huaja, një ngjitje më të shpejtë në zinxhirin e vlerës, si dhe të një pranie më të madhe të Shqipërisë në këtë sektor.

Pas shqyrtimit të disa vendeve, Austria u zgjodh si vend i synuar. U përgatit një propozim vlere, i ndjekur nga një prezantim i shkurtër i industrisë së automobilave në Shqipëri.

Me mbështetjen e Grupit të Bankës Botërore (WBG), AIDA zgjodhi 180 kompani, të cilat u kontaktuan përmes postës elektronike, postës dhe thirrjeve telefonike.

Mbështetur nga WBG dhe në bashkëpunim me Advantage Austria, AIDA kishte planifikuar të vizitonte Austrinë në mars 2020, për të prezantuar propozimin e vlerës së Shqipërisë dhe për të diskutuar mundësitë e investimeve në sektorin e automobilave dhe industritë e lidhura të prodhimit.

Për shkak të pandemisë COVID-19, vizita dhe faza përfundimtare e fushatës së shtrirjes u shty për një kohë të pacaktuar. Kompanitë, të cilat kishin planifikuar takime janë njoftuar në përputhje me rrethanat.

3.2.6.2. Gjenerimi i Leads, ndjekja dhe follow up i tyre

AIDA vazhdimisht asiston kompanitë e interesuara duke u mundësuar informacion të përditësuar mbi klimën e biznesit në Shqipëri, sistemin e taksave, lehtësirat që ofrohen për

investitorët e huaj, kuadrin ligjor për investimet, mundësitë për partneritete me biznese vendase etj.

Në përfundim të vitit 2020 u arrit numri i 8 projekteve "Lead" në ndjekje. Shtetet e tyre të origjinës janë kryesisht Italia dhe Gjermania, ndjekur nga kompani holandeze, kineze dhe japoneze, të cilat kanë shprehur interesin për realizimin e investimeve në Shqipëri. Vlera totale e këtyre investimeve arrin përafërsisht 94 milionë euro, ndërsa parashikohet që numri i të punësuarve në këto aktivitete të jetë mbi 4090.

Për sa u përket fushave të aktivitetit të këtyre projekteve, interesi kryesor ka qenë në sektorët e manufakturës, industrisë automotive, si dhe industrisë përpunuese.

3.2.6.3. Gjenerimi i investimeve të reja

Që prej hapave të para të krijimit të biznesit në Shqipëri, AIDA ka ofruar me sukses asistencë ndaj investimeve të rëndësishme të ardhura rishtazi në sektorin automotive në dy vitet e fundit, kompani të tilla si Giobert, Delmon, Rework (B-810), Yura Corporation, Sumitomo Group (Sews-Cabind), të cilat kanë zgjeruar aktivitetin në terma investimi si dhe numër punonjësish edhe përgjatë 2020. Për shkak të efekteve të pandemisë dhe pasigurisë që ka krijuar për investime të reja në kompanitë që operojnë me zinxhirë globalë vlere, përgjatë 2020 në AIDA janë shfaqur interesa për prodhimin e materialeve mbrojtëse të shëndetit.

3.2.6.4. AfterCare

Gjatë vitit 2020, Sektori AfterCare ka vazhduar të jetë në dispozicion të investitorëve ekzistues në Shqipëri, të huaj apo vendas. Pandemia kushtëzoi mjaft kryerjen e veprimtarive normale të sektorit siç janë takimet nga afër me biznesin, por gjithashtu kushtëzoi realizimin e planit të veprimit të AfterCare duke shtyrë disa aktivitete për një periudhë tjetër më të përshtatshme në të ardhmen. Megjithatë, duke ndjekur praktikat më të mira ndërkombëtare dhe duke u përshatur me kushtet e situatës së krijuar, shërbimi AfterCare vijoi kontaktin e vazhdueshëm me kompanitë për të ofruar asistencë dhe zgjidhur problematikat e hasura nga bizneset.

Pavarësisht kushteve të vështira, gjatë vitit 2020 janë zhvilluar 14 takime pranë kompanive. Gjithashtu, janë finalizuar me sukses 32 aktivitete asistence, ndërsa 4 çështje vijnë të jenë në ndjekje. Kompani si Yura Corporation, Delmon Group, Giobert, Form International, Volaria, SV Mega, PSZ Albania, Forchner etj, janë vetëm disa nga shembujt e mirë të efikasitetit të asistencës së dhënë nga AIDA. Duhet theksuar se aktivitetet e asistencës janë shtuar në krahasim me vitin 2019, dhe kanë tejkaluar dyfishin e shifrës së arritur dy vite më parë.

3.2.6.5. Plani i veprimit të AfterCare gjatë COVID-19

Me qëllim evidentimin e ndikimit të pandemisë COVID-19 mbi bizneset, Drejtoria e Investimeve realizoi dy pyetësorë për të identifikuar problemet kryesore dhe sugjerimet për trajtimin e situatës së krijuar, nga këndvështrimi i biznesit. Rezultatet hedhin dritë mbi brishtësinë financiare të shumë bizneseve dhe ndikimin e madh që COVID-19 pati në këto biznese pas fillimit të kufizimeve të ndërmarra për parandalimin e përhapjes. Rezultatet, gjithashtu, japin indicie mbi pritshmëritë e bizneseve lidhur me ndikimin afatgjatë të COVID-19, si dhe perceptimet e tyre për paketat e ndihmës së ofruara nga qeveria.

3.2.6.6. Pyetësori "Ndikimi i Covid-19 mbi bizneset në Shqipëri"

Ky pyetësor pati si synim të përcaktonte situatën e krijuar si rezultat i COVID-19 për bizneset e huaja dhe shqiptare që operojnë në Shqipëri, me xhiro vjetore nën 14 milionë lekë dhe mbi 14 milionë lekë.

- Hapi i parë konsistonte në njoftimin e bizneseve përmes postës elektronike, mbi paketat financiare mbështetëse të krijuara për situatën, duke i kategorizuar sipas qarkullimit vjetor dhe lejimit ose jo të aktivitetit.
- Pas komunikimit të parë, këto biznese u asistuan drejtpërdrejt dhe u pyetën përmes bisedave telefonike në lidhje me mënyrën se si ata po menaxhojnë situatën, problemet e hasura, si dhe mbledhjen e rekomandimeve që ata mund të kenë për pushtetin qen-

realizuar në bazë të disa pyetjeve të strukturuar.

- Targeti kryesor i pyetësorit ishin plot 200 kompani të industrive të ndryshme me vendodhje në disa qytete të Shqipërisë.
- Kompanitë e anketuara përfaqësojnë sektorë të industrisë prodhuese dhe përpunuese (fason), të tilla si tekstile, lëkurë, këpucë, automotive, agropërpunim, miniera, sektori i shërbimeve, TIK, telekomunikacion, turizëm, etj.

Rezultatet e të dhënave të analizuar treguan se shumica e kompanive pjesë e pyetësorit, e vlerësuan situatën e krijuar nga Covid-19 si një impakt negativ që ndikoi në performancën e tyre ekonomike dhe për shumicën e tyre pati një ulje të të ardhurave vjetore. Lidhur me masat mbështetëse të ndërmarra në kuadër të situates bizneset shprehën rekomandimet e tyre, të cilat ishin kryesisht me bazë financiare dhe më së shumti drejtuar qeverisë qendrore.

Pyetësori shërbeu si një reflektim të situatës në të cilën u gjenden bizneset dhe gjithashtu si një indicie lidhur me pritshmëritë mbi masat e tjera lehtësuese që do të ndërmerreshin në vijim.

3.2.6.7. Pyetësori "Impakti i Covid-19 në sektorin e turizmit"

Në zbatim të Planit të Veprimit të ndërmarrë nga AIDA për të ndihmuar bizneset e prekura nga situata e krijuar nga COVID-19, Sektori i Investimeve dhe AfterCare realizoi pyetësorin "Ndikimi i Covid-19 në sektorin e turizmit".

- Stafi i Sektorit Investime & AfterCare u ka komunikuar elektronikisht paketën me masat e përkohshme mbështetëse për sektorin e turizmit, operatorëve dhe agjencive të udhëtimit operues në vend.
- Në vijim është realizuar dhe një tour me telefonatë me disa prej subjekteve që zhvillojnë shërbimin e tyre në këtë sektor, si dhe me shoqata biznesi që përfaqësojnë zërin e këtij sektori.
- Telefonatat janë zhvilluar duke komunikuar me subjektet me qëllim përcaktimin e situatës së krijuar dhe evidentimin e ndikimit që COVID-19 ka pasur në sektorin turistik, problematikat kryesore që bizneset kanë hasur, mënyrat e menaxhimit të situatës, si dhe mbledhjen e komenteve dhe sugjerimeve

mbi masat shtesë, që janë gjykuar nga ana e bizneseve si të nevojshme për t'u ndërmarrë nga Qeveria.

- Shoqata e Turoperatorëve dhe Agjencive Turistike (ATOA) ka përcjellë problematikat e raportuara, duke ofruar gjithashtu sugjerime konkrete që mund të lehtësojnë dhe ndihmojnë rimëkëmbjen e rrjetit të operatorëve dhe vetë turizmit gjatë kësaj periudhe jo të lehtë për ekonominë mbarëbotërore.
- Për më tepër, Stafi i Sektorit Investime & AfterCare ka kryer një analizë për sa i përket impaktit që ka në ekonomi pagimi i tatimit nga bizneset, të cilat operojnë në Shqipëri si agjenci apo operatorë turistikë.
- Bizneset e kontaktuara kanë shprehur komentet e tyre për sa i përket masave të ndërmarra nga Qeveria në përgjigje të situatës së krijuar nga COVID-19. Si masat më pozitive janë vlerësuar shtyrja e pagesave mbi tatimfitimin për vitin 2019 dhe masat e veçanta të marra për operatorët turistikë, agjencitë e udhëtimit dhe klientët.

Bizneset shprehën dhe sugjerimet e tyre lidhur me masat lehtësuese, të cilat u pasqyruan në një raport më të detajuar.

3.2.6.8. Vlerësimi i shërbimit AfterCare të AIDA-s si histori suksesi në Ballkanin Perëndimor

AIDA ka pasur pjesëmarrje aktive në Projektin WB6 IPP (Western Balkans Investment Policy and Promotion) të ndërmarrë nga IFC/World Bank. Nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm, AIDA ka qenë një partner kyç jo vetëm në realizimin e suksesshëm të këtij projekti, por edhe në vijimësinë e suportit ndaj investimeve të huaja në Shqipëri.

Në përfundim të këtij projekti, IFC/World Bank ka vlerësuar aktivitetet dhe arritjet e AIDA-s, veçanërisht në ofrimin e vazhdueshëm të shërbimeve të dedikuara AfterCare ndaj investorëve të huaj në vendin tonë, si dhe asistencën e pandërprerë gjatë kushteve të vështira të situatës së shkaktuar nga pandemia e COVID-19. Bazuar në rezultatet pozitive të arritura nga AIDA dhe zhvillimet në lidhje me shërbimin ndaj investorëve, Shqipëria do të paraqitet nga ana e IFC/World Bank si histori suksesi në rajonin e Ballkanit Perëndimor.

3.2.6.9. Programi me qeverisjen lokale dhe bashkëpunimi me IFC/Bankën Botërore

Që prej gati tre vitesh AIDA ka patur një rol proaktiv ndaj përqasjes së investitorëve të huaj të pranishëm në Shqipëri. Për këtë qëllim pranë këtij institucioni vepron një organ i dedikuar për përkujdesjen ndaj investitorëve të huaj ose shqiptarë, që janë tashmë të vendosur në Shqipëri, duke i asistuar për çdo problematikë që mund të kenë gjatë zhvillimit të planit të tyre të biznesit, duke lehtësuar procedurat me institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim krijimin e kushteve për riinvestime.

Në kuadër të një Plani Veprimi të përpiluar për vitin 2018-2019, AIDA është përfshirë në krijimin e një rrjeti efektiv komunikimi e bashkëpunimi me aktorë të rëndësishëm në nivel lokal dhe qendror në funksion të nxitjes së këtyre riinvestimeve.

AIDA ka institucionalizuar bashkëpunimin me qeverisjen lokale, për të qenë në një sinergji të përbashkët kundrejt përmirësimit të shërbimit të investitorëve të huaj të pranishëm dhe gjenerimin e investitorëve të rinj. Me asistencën e IFC/Banka Botërore, AIDA po zhvillon një mekanizëm në zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave të investitorëve në Shqipëri.

Faza e parë e nismës ka qenë trajnimi i stafit të dy bashkive pilote (Elbasan dhe Lezhë) mbi shërbimet "Investment Promotion & Aftercare". Kjo fazë kishte për qëllim testimin e efektshmërisë së mekanizmit.

Gjatë fazës së dytë janë trajnuar stafet e 6 bashkive të përfshira (Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat) për ta shtrirë kështu njohjen dhe përvetësimin e konceptit AfterCare.

Duke vijuar, rrjeti i bashkëpunimit me qeverisjen lokale është zgjeruar me 8 bashki në gjysmën e parë të vitit pasardhës.

Janë përcaktuar "focal points" në çdo bashki dhe është trajnuar stafi mbi konceptin AfterCare dhe mënyrën e organizimit të vizitave pranë bizneseve. Faza e tretë ka qenë përzgjedhja e 2 kompanive për secilën bashki dhe organizimi i vizitave në këto qarqe.

Në vazhdimësi të punës së vitit të mëparshëm,

gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019 është riaktivizuar rrjeti i bashkëpunimit me 41 takime në bashkëpunim me 8 bashkitë e vendit: Shkodër, Vlorë, Tiranë, Durrës, Berat, Lezhë, Fier dhe Elbasan. Këto takime kanë konsoliduar raportin mes qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke patur në vëmendje investitorët ekzistues dhe sidomos nxitjen e riinvestimeve. Në fund të 41 takimeve AIDA ka përpiluar një raport të hollësishëm, i cili i është dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në funksion të një panorame më të qartë mbi klimën e biznesit në Shqipëri dhe përmirësimit të mëtejshëm.

AIDA ka një rol proaktiv në përqasjen e investitorëve të huaj tashmë të pranishëm në Shqipëri. Sektori AfterCare është në komunikim të vazhdueshëm me grupet përkatëse të interesit, të rëndësishëm në nivelin lokal dhe qendror, me qëllim promovimin e riinvestimit në Shqipëri. Ky bashkëpunim nuk është ndalur me takimet e mësipërme, por vijon përgjatë punës së përditshme të AIDA-s duke ndjekur hap pas hapi kompanitë që operojnë në vendin tonë dhe duke i ndërlidhur me institucionet shtetërore për një mbarëvajtje sa më efikente të planit të tyre të biznesit.

Efektivisht kjo përkthehet në rritjen e vendeve të punës dhe përmirësimin e përgjithshëm të klimës së investimeve në vend.

Plani i Veprimit shtrihet tashmë në vitin 2020. Faza e parë e projektit do të përfshijë trajnimin e stafit të 2 Bashkive të reja (përkatësisht Vorë dhe Kavajë) mbi konceptin AfterCare së bashku me GIZ, duke zgjeruar rrjetin e bashkëpunimit të AIDA-s. Qëllimi i njohjes me konceptin e Aftercare, nuk është vetëm prezantimi i stafit të bashkive me Shërbimin AfterCare për investitorët ekzistues, por edhe lehtësimi, ndërmjetësimi i kompanive në çështje që lidhen me aktivitetin e tyre. Kjo ndihmon në mbrojtjen e investimeve ekzistuese dhe zgjerimin e tyre të vazhdueshëm.

Në fazën e dytë, Sektori AfterCare dhe përfaqësuesit e bashkive ndërmarrin takime në kompani të ndryshme në mënyrë që të marrin informacion në lidhje me zhvillimin e biznesit, punësimin, eksportet, planet afatshkurtra dhe

dhe afatgjata, duke synuar inkurajimin e riinvestimit. Bazuar në Planin Vjetor të Veprimit të AIDA-s, 5 kompani do të përzgjidhen për secilën bashki, për t'u vizituar nga stafi përkatës.

Në fazën e tretë do të hartohet një raport analizë me rekomandime në lidhje me takimet, i cili u dërgohet institucioneve vendimmarrëse, siç është MFE për të ndërmarrë politikat e nevojshme në mbështetje të biznesit.

3.2.7. Pronat shtetërore dhe zonat me përparësi zhvillimi

Bazuar në legjislacionin sektorial, propozimi për shpalljen e zonave me përparësi zhvillimi mund të bëhet nga ministrat e linjës, AIDA dhe Komiteti i Investimeve Strategjike.

Identifikimi, shpallja dhe përcaktimi i mënyrës dhe rregullave të funksionimit të zonave, të cilat do të konsiderohen me përparësi zhvillimi, kryhet rast pas rasti, nga Këshilli i Ministrave, me vendim të posaçëm.

Bazuar në VKM-në nr. 1023/2015, zhvillimi i zonave me përparësi zhvillimi fokusohet, kryesisht, në:

a) orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, me qëllim nxitjen e përqendrimit të llojeve të njëjta apo të ngjashme të industrive apo veprimtarive tregtare, në mënyrë që të përfitohet nga specializimi i punëkërkuësve, ekonomitë e shkallës dhe ndarja e kostove infrastrukturore. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë rritjen e eficiencës së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim, si edhe do të ndërmerren masa për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet industriale;

b) orientimin e investimeve në zona të caktuara territoriale, në të cilat ka nivele të larta papunësie dhe ku zhvillimi ekonomik është në nivele të pakënaqshme, krahasuar me rajone të tjera të vendit. Për këtë qëllim do të përdoren mekanizma nxitës, të cilët synojnë zhvillimin ekonomik, rritjen e mirëqenies së popullatës, rritjen e punësimit dhe formimin profesional, si dhe përmirësimin e infrastrukturave.

Kriteret ndihmëse për identifikimin e zonave me përparësi zhvillimi do të jenë:

- studimi i vendndodhjes, përqendrimit, numrit dhe rëndësisë ekonomike të veprimtarive

qëllim krijimin e sinergjive ekonomike ndërmjet tyre;

- analiza e gjendjes së infrastrukturave ekzistuese apo në zhvillim;
- niveli i papunësisë së zonës;
- të ardhurat ekonomike për banor si edhe kriteret të tjera ndihmëse, sipas nevojave dhe strategjive publike;
- realizimi i objektivave të mbrojtjes efektive mjedisore;
- shfrytëzimi me efektivitet i aftësive e kualifikimeve të veçanta të punëkërkuësve aktivë të zonës;
- statistikat e zhvillimit ekonomik të zonës përkatëse, sipas studimeve të INSTAT-it apo enteve të tjera publike;

Gjatë vitit 2020, AIDA ka identifikuar dhe ka kryer verifikimet e nevojshme për zonat, të cilat kanë potencialin e nevojshëm dhe plotësojnë kushtet për t'u konsideruar si zona me përparësi zhvillimi.

Zonat në fjalë janë zona me potencial për krijimin e një poli ekonomik, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të bashkive përkatëse, çka do të mund të realizohet nëpërmjet investimeve të ndryshme.

Shpallja e një zone me përparësi zhvillimin do të mundësojë rihvillimin dhe pasurimin e saj me funksione të ndryshme, duke ndikuar në rritjen e ekonomike të zonës. Objektivi kryesor i shpalljes së një zone me përparësi zhvillimi, do të mundësojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, duke ruajtur balancat mes sektorëve të ndryshëm të ekonomisë në territor dhe duke rritur konkurrencën dhe larminë ndërmjet sektorëve aktivë të rajonit për të gjeneruar punësim të vazhdueshëm.

Më konkretisht, AIDA, gjatë vitit 2020, ka identifikuar zonat:

Prona	Ish-Kombinati Metalurgjik
Vendndodhja	Njësia Administrative Bra-dashesh, Elbasan
Zona Kadastrale	3965

Ish-Kombinati Metalurgjik shtrihet në tokë bujqësore përgjatë luginës së Shkumbinit, në Fushën e Bradasheshit, 2-3 km në jugperëndim të qytetit të Elbasanit, në njësinë administrative Bradashesh.

Prona ndodhet në zonën industriale. Ka akses direkt me aksin rrugor Tirana – Elbasan – Rrogozhinë, duke e bërë këtë zonë mjaft atraktive. Gjithashtu, zona është e aksesueshme me transport urban publik. Rigjallërimi i këtij territori do të stimulonte investime të tjera në zonë dhe zhvillimin sektorial dhe makroekonomik.

Aseti Uzina e Plehrave Azotike

Prona	Aseti Uzina e Plehrave Azotike
Vendndodhja	Njësia Administrative Fier
Zona Kadastrale	1557

Zona industriale e Azotikut është një ndër pollet ekonomike më identifikuese të qytetit të Fierit. Me një sipërfaqe rreth 60ha, zona përfshin Parkun Industrial të Prodhimit të Azotit, zonën e Rafinerisë së Naftës, si dhe ish-TEC-in. Nga këto objekte industriale, aktualisht në funksionim është Rafineria e Naftës, si dhe disa objekte të Azotikut, si objektet që prodhojnë gaz të lëngshëm, kullat e ftohjes etj. Parku i Azotikut përbëhet nga tre seksione, të specializuara sipas prodhimit të dikurshëm: azotiku, ureja e re dhe ureja e vjetër. Aktualisht, pjesa më e madhe e objekteve janë privatizuar, dhe janë në proces likuidimi dhe demolimi, për t'u shitur në ankand si pjesë të veçanta. Zona përbën një element të fortë të qytetit, i cili mund të rikthehej në një pol rekreativ.

Aseti Fabrika e Duhan Cigareve

Prona	Aseti Fabrika e Duhan Cigareve
Vendndodhja	Shkodër
Zona Kadastrale	8592

Aseti Ish=Fabrika e Duhan-Cigareve përbëhet nga disa godina të ndara në reparte dhe në depo. Vetëm një pjesë e ish-fabrikës është privatizuar, por aty nuk prodhohet duhan, por

këpucë. Të gjitha godinat e tjera të mëdha kanë degraduar. E pozicionuar në qendër të ndërlidhjes së bashkive Malësi e Madhe, Vau Dejës, Pukë, Lezhë dhe në qendër të ndërlidhjes ndërkufitare me bregdetin e Malit të Zi, liqenin e Shkodrës dhe në aksin e dy kryeqyteteve Tiranë dhe Podgoricë, Shkodra luan dhe do të luajë gjithmonë një rol kyç në ofrimin e shërbimeve të sistemit ekonomik, logjistik, arsimor, social e kulturor për të gjithë rajonin dhe komunitetin e Veriut, madje shtrirë dhe përtej kufirit. Rihvillimi dhe rehabilitimi mjedisor i kësaj zone, që është pothuajse jashtë funksionit për momentin, ka nevojë për trajtim rehabilitues të thellë, në mënyrë që të mund të rivendosen në funksione të ngjashme ekonomike.

Uzina e telave dhe e kabllave

Prona	Uzina e telave dhe e kabllave
Vendndodhja	Shkodër
Zona Kadastrale	8592

Uzina e telave dhe e kabllave ndodhet në zonën veriore të qytetit, pikërisht në zonën industriale. Ka akses direkt me rrugën kryesore që lidh Shkodrën me Malin e Zi duke e bërë këtë zonë mjaft atraktive. Gjithashtu, zona është e aksesueshme me transport urban publik. Zona karakterizohet nga dinamika pozitive demografike, me një përqendrim të lartë të fuqisë punëtore të kualifikuar, në krahasim me qytetet e tjera të vendit.

Rigjallërimi i këtij territori do të stimulonte investime të tjera në zonë dhe zhvillimin sektorial dhe makroekonomik.

Ish-Vaskat e Peshkut

Prona	Ish-Vaskat e Peshkut
Vendndodhja	Njësia Administrative Drenovë, Korçë
Zona Kadastrale	1538

Prona shtrihet në Drenovë, pesë kilometra larg Korçës, në juglindje të saj, midis dy lumenjve të vegjël, në rrugën që të çon për në Kolonjë, një pozitë kjo mjaft e përshtatshme gjeografike, e cila ka një klimë të mirë për tokat pjellore të saj.

Në këtë zonë, ekonominë e dominon bujqësia. Në arat e saj mbillen gruri, misri, fasulja ndër-sa pemëtaria dallohet me kultivimin e pemës së manit te zi, mollës, dardhës, kumbullave, qershive dhe pemë të tjera që i përshtatën klimës së Shqipërisë. Me gjithë pozicionin e largët, zona përfaqëson një industri turizmi i cili siguron një burim për aktivitetin ekonomik dhe të ardhurat.

Në përfundim të gjithë analizave dhe verifikimeve të kryera, AIDA, do të vlerësojë, në fillim të vitit 2021, zonat që do të propozojë pranë ministrisë së linjës, si zona me përparësi zhvillimin.

3.2.8. Iniciativa të AIDA-s në kuadër të investimeve

3.2.8.1. Përpunimi dhe publikimi i Inventarit të Incentivave

Në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë është hartuar inventari i nxitësve të investimeve në Shqipëri. Ky inventar u përpilua në vijim të Planit të Veprimit të Reformës së Investimeve (IRAP) në kuadër të MAP REA, me qëllim paraqitjen shteruese dhe të përditësuar të masave lehtësuese dhe incentivuese të ndërmarra nga Qeveria e Shqipërisë në mbështetje të biznesit vendas dhe të huaj dhe nxitjes së investimeve të huaja në Shqipëri. Inventari përmban një total prej 45 nxitësish, shoqëruar nga përshkrimet e tyre, legjislacionin mbi të cilin mbështeten, institucionet përgjegjëse, sektorët përkatës ekonomikë, kriteret përkatëse për përfitimin e tyre etj. Për të ofruar një akses sa më efektiv, ky inventar është publikuar online në faqen zyrtare të AIDA-s.

3.2.8.2. Paketat informuese mbi ndryshimet e ligjit për të huajt

AIDA është angazhuar gjatë vitit 2020 në përpilimin e disa paketave specifike informuese të cilat vijnë në ndihmë të investitorëve të huaj duke ju ofruar zgjidhje lidhur me çështje apo problematika që ata hasin para ose gjatë realizimit të investimeve të tyre. Në vijim gjendet një listë me këto paketa të cilat përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet apo risitë që dalin në ligj.

- Paketë informuese lidhur me kriteret, procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë;
- Paketa informuese lidhur me fitimin e shtetësisë shqiptare, procedurat dhe dokumentacioni përkatës;
- Paketë informuese lidhur me pajisjen e të huajve me viza dhe leje qëndrimi;
- Paketa informuese lidhur me punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë dhe llojet e lejeve të punës.

3.2.8.3. Analizat e Impaktit të COVID-19 mbi IHD

Zhvillimet që kanë ardhur si rrjedhojë e situatës së pandemisë së Covid-19 janë ndjekur në mënyrë të afërt nga Drejtoria e Investimeve. Stafi i AIDA-s ka qenë i angazhuar në mënyrë të vazhdueshme në identifikimin e pasojave që kjo pandemi do sillte në terma afatshkurtër për bizneset e huaja të pranishme në Shqipëri dhe për impaktin që kjo situatë do kishte mbi prurjet e investimeve të huaja direkte në plan më afatgjatë në vendin tonë.

Hulumtimet e kryera mbi këto tematika u konkretizuan me prodhimin e dy materialeve në formë prezantuese. Materiali i parë u krye në periudhën e marsit. Ky material trajtonte parashikimet fillestare të impaktit të Covid mbi rënien e flukseve globale të IHD-ve. Sipas parashikimeve fillestare të UNCTAD, publikuar më 8 mars 2020, parashikohej se pandemia COVID-19 mund të shkaktojë rënie në flukset globale të investimeve të huaja direkte duke zbritur në nivelet më të ulëta që nga kriza financiare e vitit 2008. Fillimisht, parashikohej një rënie globale e IHD-ve rreth 5% - 15% krahasuar me periudhat e mëparshme. Ky impakt është trajtuar në termat e rajoneve të prekur dhe në terma sektoriale.

Materiali i dytë është punuar në nëntor 2020. Ky material krahason pritshmëritë fillestare mbi pandeminë me situatën aktuale në fund të vitit. Raporti i përditësuar nga UNCTAD, publikuar në maj 2020, parashikonte rënien e vlerës totale të IHD-ve në rang global për vitin 2020 rivlerësohet mes 30% dhe 40% krahasuar me vitet e mëparshme. Shifrat zyrtare konfirmuan

parashikimet e rishikuara. Gjysma e parë e vitit 2020, pati një rënie prej 49% në flukset e IHD-ve në botë. Ekonomitë e zhvilluara patën një rënie prej 75% në flukset e IHD-ve në gjysmën e parë të vitit 2020, ndërsa IHD-të në ekonomitë në zhvillim kanë rënë me 16%, më pak sesa pritej. Sipas të dhënave të Bankës së Shqipërisë, rënia e fluksit të investimeve të huaja direkte në Shqipëri ka qenë në nivelin 11%, brenda parashikimit fillëtar të realizuar nga UNCTAD.

Analiza, gjithashtu, ka trajtuar numrin e projekteve të shpallura të IHD-ve sipas sektorëve në rajon dhe në botë. Gjithashtu, është trajtuar impakti sektorial i pandemisë në IHD në disa prej shteteve më të rëndësishme dhe impakti që ka pasur mbi fluksin dhe stokun e IHD-ve në Shqipëri.

3.2.8.4. Integrimi i platformave digjitale në funksion të tërheqjes së investimeve

Me synimin për të përmbushur rolin e saj në promovimin sistematik dhe të targetuar të investimeve në kuadër të Strategjisë BIDS (Business Investment Development Strategy), AIDA është angazhuar në gjetjen e mjeteve sa më efektive që do ndihmonin në arritjen e këtij objekti. Përdorimi i platformave digjitale në promovimin e investimeve njihet si një mjet që rrit në mënyrë cilësore suksesin e fushatave të targetuara për përthithjen e investimeve të huaja (outreach campaigns). Bazuar në eksperiencën e punës së përditshme të stafit të investimeve në shqyrtimin e raporteve ndërkombëtare dhe bashkëpunimin me institucionet dhe partnerët ndërkombëtare, një platformë e tillë do përmbushte në mënyrë efektive nevojat e AIDA-s në qasjen proaktive ndaj tërheqjes dhe lehtësimit të Investimeve të Huaja në Shqipëri.

Aksesi në një platformë të tillë është gjithashtu i rëndësishëm në vijim të bashkëpunimit që AIDA ka me Harvard Growth Lab, të cilët kanë ndërtuar Industry Targeting Dashboard (<https://growthlab.app/albania-tool>), një mjet ndihmues në procesin e targetimit. Ky mjet jep mundësinë e përzgjedhjes nga 272 industri dhe jep informacion mbi përputhjen e industrive përkatëse me aftësitë aktuale prodhuese të Shqipërisë, si

dhe avantazhet dhe disavantazhet krahasuese. Me integrimin e një platforme digjitale në Dashboard, krahas targetimit të industrive, shfaqen gjithashtu kompanitë kryesore me potencial investimi në ato fusha. Aksesi në këto të dhëna është një ndihmesë e madhe në krijimin e listave cilësore në funksion të targetimit.

Për të vlerësuar opsionet më të mira dhe shërbimet më cilësore që ofrohen nga këto platforma digjitale, stafi i AIDA-s ka zhvilluar një kërkim tregu, me synim blerjen e një platforme të tillë. AIDA ka kontaktuar disa nga kompanitë më të rëndësishme në këtë fushë dhe ka marrë oferta konkrete prej tyre. Mbi këto oferta është bërë një analizë e brendshme për përzgjedhjen e platformës më të përshtatshme dhe cilësore për nevojat e agjencisë. Ky gjykim është ndarë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe është në fazë shqyrtimi.

3.2.8.5. Pjesëmarrja e AIDA-s në tryeza pune vendimmarrëse

Sektori i Bujqësisë

Në vijim të urdhrit të përbashkët të punës midis MFE dhe MBZHR, me objekt "Vlerësimin dhe propozimin e nje plani pune të koordinuar me të gjithë palët e përfshira" me qëllim final krijimin e kushteve të favorshme për investime të qëndrueshme në sektorin e agropërpunimit, gjatë vitit 2020 janë realizuar disa mbledhje të grupit teknik të punës, ku pjesëmarrëse ka qenë edhe AIDA. Diskutimet e realizuara gjatë 3 mbledhjeve ishin baza e mbledhjes së zhvilluar më 10 nëntor 2020 e cila synonte shqyrtimin e potencialeve për investime në nënsektorët e zgjedhur (arvore, domate, lëngjet e frutave dhe BMA), përfshirë sfidat kryesore të biznesit dhe nevojat për mbështetje.

Sektori i Energjisë

Në bazë të urdhrit të uërbashkët për "ngritjen e grupit teknik për vlerësimin e potencialeve të investimeve në sektorin e energjisë" mes Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, AIDA është pjesë e grupit të punës, i cili shqyrton projektet e potenciale për investim në sektorin energjetik, duke patur kështu rol këshillues,

vendimmarrës. Ky grup përbëhet nga dy Zv/min-istrat përkatësisht të MFE dhe MIE dhe anëtarë nga të dy institucionet. Grupi i punës ka bërë një mbledhje ku pjesëtarët janë njohur me detyrat përkatëse, dhe është përgatitur një dokument nga ana e AIDA-s, i cili ka përcaktuar kërkesat dhe pyetjet e investitorëve potencialë në energji, por dhe problematikat me të cilat hasen investitorët ekzistues në këtë sektor, të cilat janë lënë për ndjekje nga MIE.

Sektori i Teknologjive të Informacionit dhe Komunikimit

Në zbatim të urdhrit të përbashkët të punës midis MFE dhe MIE "Për ngritjen e Grupit Teknik për vlerësimin e potencialeve të investimeve në sektorin e dixhitalizimit", AIDA është anëtare e Grupit të Punës dhe pjesëmarrëse në tavolina pune mbi krijimin e legjislacionit dhe strategjive në mbështetje të sektorit TIK, me qëllim final stimulimin e agjendës digjitale dhe krijimin e kushteve të favorshme për investime në këtë sektor.

Në këtë drejtim, duke vlerësuar ndikimin që ka zhvillimi i tregtisë elektronike (e-commerce) në digjitalizimin dhe rritjen ekonomike të Shqipërisë, në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 110, datë 10.9.2020 "Për ngritjen e Grupit Ndërinstitucional të Punës për hartimin e Planit të Veprimit për tregtinë elektronike, për periudhën 2021-2024", AIDA është pjesë e Grupit të Punës Ndërinstitucional, si dhe Grupit Teknik për "Kapacitetet dhe aftësitë e sektorit privat për tregtinë elektronike".

AIDA ka qenë pjesëmarrëse në takimet e organizuara me pjesëmarrjen e ekspertëve të Bankës Botërore, dhe ka dhënë kontributin e saj në hartimin e Planit të Veprimit për Zhvillimin e Tregtisë Elektronike 2021-2024. Krahas propozimeve të AIDA-s në shtyllën e katërt të Planit të Veprimit "Kapacitetet e sektorit privat" në funksion të mbështetjes për e-sipërmarrjen, Drejtoria e Investimeve ka dhënë kontributin e saj duke propozuar masa konkrete në funksion të tërheqjes së investimeve të huaja direkte dhe ridrejtim të tyre në sektorin e TIK-ut. Masat e propozuara përmbajnë përfshirjen e investimeve në sektorin ICT/BPO në skemën e Kontratës 1 Euro, si dhe

vlerësimin dhe aktivizimin e TEDA-ve me potencial digjitalizimi.


3.3. Investimet Strategjike

3.3.1. Hyrje

Me hyrjen në fuqi të paktës së re ligjore për investimet strategjike (datë 24.12.2015), u bë e mundur që investimet e vendase dhe të huaja, në sektorët më të rëndësishëm të shpallur strategjikë, të lëvizin më me shpejtësi, me procedura të përsheptuara dhe favorizuese.

Në zbatim të kësaj pakete ligjore, AIDA ka tre funksione të tjera shtesë:

- One Stop Shop për aplikimet për investim/ investitor strategjik
- Sekretariat Teknik i Komitetit të Investimeve Strategjike (KIS)
- Agjent asistues i investitorit strategjik



Referuar legjislacionit të investimeve strategjike, AIDA në cilësinë e One Stop Shop ka të gjithë autoritetin e nevojshëm për të pranuar dosjet, shqyrtuar, kontrolluar përputhshmërinë e aplikimeve, dhe më pas të koordinojë vendimarrjen. Në këtë aspekt, One Stop Shop:

- kryen veprimet përgatitore dhe shërbimet e nevojshme ndaj projektit potencial strategjik dhe investitorit/investitorëve potencialë strategjik (pra dy statuse të ndryshme), veçanërisht ato të verifikimit të tokës dhe përputhjes së projektit të investimit me planin kombëtar të rregullimit të territorit (proces i cili përfshin një sërë institucionesh njëkohësisht);
- koordinon procesin vlerësues të një projekti nga Grupi Operacional, me shpejtësi dhe efikasitet (brenda një afati maksimal prej 30 ditësh);
- përgatit raportet për KIS, në rolin e Sekretariatit Teknik dhe harton një sërë aktesh administrative pas vendimeve të KIS.

3.3.2. Projektet e vlerësuara nga Komiteti i Investimeve Strategjike (KIS) përgjatë vitit 2019 dhe 2020

Projekte të shqyrtuara nga AIDA 2019-2020

Viti	2019	2020	Totali
Projekte totale	8	7	15
Projekte të miratuar	5	5	10
Projekte të refuzuara	3	2	5

Përveç sa më sipër, përgjatë vitit 2020 AIDA ka asistuar në fazë paraprake edhe 7 projekte, të cilat, për arsye të ndryshme nuk janë pranuar si aplikime ose subjektet aplikues nuk kanë vijuar me aplikimin përfundimtar, duke e çmuar atë për një moment të dytë.

Duhet theksuar se vështirësitë që kaloi vendi për shkak të përhapjes së sëmundjes infektive COVID-19, si dhe masave kufizuese përgjatë gjithë vitit 2020 ngadalësuan deri diku ritmin e shqyrtimit të aplikimeve, ose bënë që subjektet investuese të rishikonin planet e tyre të investimit,

megjithëkëtë, duke pasur parasysh krahasimin me vitin e kaluar (2019), projektet e miratuara kanë ruajtur të njëjtin nivel (5 projekte të miratuara), madje, në raport me numrin e aplikimeve të shqyrtuara, kjo shifër ka një rritje të lehtë ë përqinsje, në krahasim me vitin e kaluar.

3.3.3. Projektet sipas sektorëve strategjikë

Projektet e shqyrtuara përgjatë vitit 2020 i përkasin kryesisht sektorit të turizmit, i cili ka numrin më të madh të projekteve të investimit, duke u ndjekur më pas nga sektori i "zonë e teknologjisë dhe zhvillimit ekonomik (TEDA)".

Viti	2019		2020	
	Total	Miratuar	Total	Miratuar
Projekte	8	5	7	5
Turizëm	6	4	5	3
Bujqësi dhe peshkim	1	0	1	1
Zonë me përparësi zhvillimi	1	1	-	-
TEDA			1	1



Nëse analizojmë më konkretisht numrin e projekteve sipas sektorëve, më poshtë evidentohen projektet në sektorët strategjikë të shpërndarë përgjatë këtyre dy viteve të fundit.

Në vitin 2019 janë shqyrtuar:

- 6 projekte në sektorin e Turizmit
- 1 projekt në sektorin e Bujqësisë dhe Peshkimit
- 1 projekt në sektorin e Zonave me Përparësi Zhvillimi

Në vitin 2020 janë shqyrtuar:

- 5 projekte në sektorin e Turizmit
- 1 projekt në sektorin "Zonë e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA)"
- 1 projekt në Bujqësi

Sikurse edhe vitin e kaluar, edhe këtë vit, pjesa më e madhe e projekteve është e lidhur me fushën e turizmit dhe arsye e vazhdimit të këtij trendi, mbetet miratimi i ligjit Nr. 93/2015 "Për Turizmin", dhe akteve nënligjore të dala në dhe për zbatim të tij, të cilët parashikojnë një sërë lehtësirash për zhvillimin e investimeve.

Në bazë të këtij kuadri rregullator (ku përfshihen edhe një sërë VKM, si: VKM nr. 162, datë 02.03.2016; VKM Nr.691, datë 05.10.2016 "Miratimin e formatit të marrëveshjes me investitorët në fushën e turizmit"; Vendim nr. 257, datë 9.5.2018 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave dhe të dokumentacionit për subjektet që aplikojnë për statusin "investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special"; VKM nr. 370, datë 29.5.2019 për disa shtesa në vendimin nr. 730, datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese"), përcaktohet qartë roli i shtetit si zhvillues, përfshirja e tij në partneritete publiko – private, përfaqësimi me aksione në sipërmarrje turistike, vënia në dispozicion e pasurive të paluajtshme si dhe siguri mi i infrastrukturës mbështetëse.

Përveç kësaj, për realizimin e investimeve në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, pasuritë e paluajtshme, në pronësi të shtetit, janë tashmë në administrim të ministrisë përgjegjëse për turizmin, kurse për sa i përket pasurive të paluajtshme, në administrim të njërive të qeverisjes vendore, që ndodhen në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, ato i kalojnë në administrim ministrisë përgjegjëse për turizmin, rast pas rasti, me vendim të Këshillit të Ministrave, brenda 2 muajve nga miratimi i zonës përkatëse si "zonë me përparësi zhvillimin e turizmit".

Kur kërkojnë, këto pasuri vihen në dispozicion të projektet e investimit në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit, për një periudhë maksimale deri në 99 vjet, me miratim të Këshillit të Ministrave. Vënia në dispozicion e tyre mund të bëhet edhe nëpërmjet kontratës simbolike prej 1 euro. Në mbështetje të ligjit "Për investimet strategjike", në rastin e investitorëve me status "Investitor Strategjik i Veçantë", Këshilli i Ministrave mund të vendosë, rast pas rasti, transferimin e së drejtës së pronësisë të pasurive të palua-

jshme shtetërore tek investitori privat, duke e kushtëzuar kalimin me realizimin e plotë të investimit.

Një parashikim tjetër i ligjit lidhet me të drejtën për përdorimin e brigjeve, parashikuar nga neni 40 i ligjit "Për turizmin", ku u njihet e drejta për projekte për të pasur në dispozicion një hapësirë të plazhit, në raport me kapacitetin e strukturës akomoduese.

Ligji për turizmin pësoi disa shtesa në vitin 2017 me ligjin Nr. 114/2017 në të cilin u parashikua dhënia e statusit special për subjektin që plotëson të gjitha kushtet e mëposhtme:

- a) është investitor në një strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, në Republikën e Shqipërisë;
- b) vlera e investimit është të paktën 8 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 4 yje dhe të paktën 15 milionë euro për ndërtimin e strukturës akomoduese me 5 yje.

Ndërkohë që në ligjin për Investimet Strategjike, nr. 55/2015, parashikohet që për marrjen e statusit strategjik vlerat për t'u përmbushur janë më të larta, konkretisht:

- a) e barabartë ose më e madhe se 5 000 000 (pesë milionë) euro, dhe, në të njëjtën kohë, duhet të krijojë, minimalisht, 80 vende të reja pune, për investitorët/projektet që do të përfitojnë statusin "Investim/investitor strategjik, procedurë e asistuar";
- b) e barabartë ose më e madhe se 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) euro, për investitorët / projektet që do të përfitojnë statusin "Investim /investitor strategjik, procedurë e veçantë".

Këto parashikime nuk shkaktojnë probleme në praktikë, pasi ligji nuk e ndalon investitorin të aplikojë në secilën prej këtyre procedurave dhe nuk janë konkurruese me njëra-tjetrën, për aq kohë sa dhe kriteret dhe përfitimet nga këto dy ligje janë të ndryshme.

3.3.4. Rezultatet si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike

Duke pasur parasysh aplikimin e legjislacionit për investimet strategjike, përgjatë viteve të fundit, përfshirë dhe vitin e vështirë 2020, si dhe shtimin e numrit të investitorëve që kërkojnë aplikimin e masave asistuese apo mbështetëse nga

AIDA dhe shteti shqiptar, duhet theksuar se ka një vlerësim tepër pozitiv mbi kuadrin ligjor ekzistues, pavarësisht se, në fillimet e zbatimit të tij, investitorët mund të kenë qenë edhe skeptikë me efektivitetin e zbatimit të tij. Por sot, është fakt se ky legjislacion është liberal, jo diskriminues për investitorët e huaj, si dhe transparent, në drejtim të incentivave dhe programeve sektoriale, me anë të të cilit janë thjeshtëzuar edhe më tej procedurat administrative.

Tashmë, si pasojë e aplikimit të legjislacionit të investimeve strategjike, projektet e investimit që aplikojnë dhe asistohen nga AIDA kanë më shumë lehtësira në marrjen e lejeve zhvillimore apo lejeve të ndërtimit, kurse masat mbështetëse janë lehtësisht të zbatueshme dhe me procedura të përsheptuara.

Zbatimi i ligjit përgjatë kësaj periudhe ka krijuar një rrjet komunikimi ndërinstitucional shumë funksional. Duhet theksuar se, për herë të parë, në janar 2020, në bazë të procedurave të ligjit për investimet strategjike, u arrit që një institucion të aplikojë tek AIDA për të kërkuar ndihmën e institucioneve të tjera me qëllim hartimin e një projekti potencial strategjik.

Së fundmi, përfshirja në ligj e zonave me prioritet zhvillimi, si një sektor strategjik, përbën një mekanizëm akoma dhe më efikas për të akomoduar investime strategjike me impakt të theksuar social dhe ekonomik për zona të veçanta.

3 NDËRMARRJET E VOGLA DHE TË MESME

3.4.1. Hyrje

Drejtoria NVM dhe Projekteve pranë AIDA-së ka si objektiv të ofrojë shërbime për mbështetjen e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM) shqiptare nëpërmjet asistencës teknike, promovimit të bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare, si dhe krijimin e lidhjeve dhe të mundësive të bashkëpunimit me bizneset e huaja. Drejtoria ndihmon ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në shfrytëzimin e financimeve publike, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM) në Shqipëri luajnë një rol të rëndësishëm në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin e vendit, shprehur kjo nëpërmjet treguesve të punësimit në sektorin privat, si dhe në kontributin e të ardhurave kombëtare.

Ndërmarrjet tregtare zënë 22,1 % të ndërmarrjeve të regjistruara gjatë vitit 2020, krahasuar me 23,0 % të regjistruara gjatë vitit 2019.

Ndërmarrjet e mëdha me 50 e më shumë të punësuar zënë vetëm 1,2 % ndaj totalit të ndër-

marrjeve.

Kontributi i tyre në punësim llogaritet në 48,5 % në vitin 2020, nga 47,8 % në vitin 2019.

Në bashkinë Tiranë janë përqendruar pjesa më e madhe e ndërmarrjeve, ndërsa në bashkinë Pustec shënohet numri më i ulët.

Gratë menaxhojnë 25,5 % të ndërmarrjeve aktive në vitin 2020, krahasuar me 25,4 % në vitin 2019. Qarku i Tiranës ka edhe përqëndrimin më të madh të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë, me 32,8 %. Ndërmarrjet e drejtuara nga gratë janë kryesisht ndërmarrje të vogla me 1 - 4 të punësuar, të cilat zënë 91,0 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Në ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar, gratë drejtojnë 22,8 % të ndërmarrjeve. Në ndërmarrjet me 50 e më shumë të punësuar, gratë drejtojnë 22,8 % të ndërmarrjeve.

Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë të huaj zënë 3,6 % të ndërmarrjeve aktive, krahasuar me 4,0 % të ndërmarrjeve aktive në vitin 2019, dhe punësojnë 12,4 % të të punësuarve gjithsej.

Ndërmarrjet nga vendet e Bashkimit Evropian përfaqësojnë 62,2 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta. Ndërmarrjet me pronarë apo bashkëpronarë me origjinë italiane dhe greke përfaqësojnë 77,8 % të ndërmarrjeve të huaja e të përbashkëta gjithsej. Ndërmarrjet e huaja e të përbashkëta janë përqëndruar kryesisht në bashkitë Tiranë dhe Durrës, përkatësisht 64,9 % dhe 12,1 %.

Në fund të vitit 2020 regjistrohen 176.216 njësi lokale nga të cilat 164.608 ushtrojnë aktivitetin ekonomik në një vendndodhje. Ndërmarrjet me më shumë se një vendndodhje janë 1.778,

të cilat përfaqësojnë vetëm 1,1 % të ndërmarrjeve aktive gjithsej. Numri i të punësuarve në to është 25,4 % e të punësuarve gjithsej.

Njësitë lokale janë përqëndruar në qarqet Tiranë, Fier dhe Korçë me 54,9 % të numrit të përgjithshëm të njësive lokale.

Për nga ndarja rajonale, rajoni më i zhvilluar është rajoni qendër ku përfshihen qarqet Tiranë dhe Elbasan, ku janë përqëndruar 41,0 % e ndërmarrjeve aktive. Pothuajse e njëjta situatë është edhe me ndërmarrjet e regjistruara gjatë vitit 2020, me 46,9 %. Të punësuarit në këtë rajon zënë 54,4 % të të punësuarve gjithsej.

Treguesit kryesorë dhe struktura e tyre sipas madhësisë së ndërmarrjes, 2019


Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrje Eksportuese (%)	Ndërmarrje Importuese (%)	Vlera e Eksportit (%)	Vlera e Importit (%)
Gjithsej	100	100	100	100
NVM (1-249 të punësuar)	97,0	98,7	59,4	78,0
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	50,7	67,7	6,1	15,4
Nd. Vogla (10-49 të punësuar)	31,4	23,4	18,1	30,0
Nd. Mesme (50-249 të punësuar)	14,9	7,6	35,2	32,6
Nd. Mëdha (250+ të punësuar)	3,0	1,3	40,6	22,0

Në numrin e ndërmarrjeve, sektori i tregtisë ka peshën më të madhe të NVM-ve me 40.1 %, ndërsa përqindjen më të ulët e ka sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 0.6 %.

Në numrin e të punësuarve, sektori i tregtisë punëson 28.5 % të NVM-ve, ndërsa sektori me numrin më të vogël të të punësuarve në NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 1.8 %. Në vlerën e shitjeve neto, sektori i tregtisë mbizotëron me 52.4 %, ndërsa sektori me përqindjen më të ulët të shitjeve të realizuara nga NVM-të është sektori i industrisë nxjerrëse me 2.4 %.

Në vlerën e investimeve, sektori me përqindjen më të lartë të investimeve të kryera në NVM-të është sektori i energjisë elektrike, ujit dhe menaxhimit të mbetjeve me 31.4 %, ndërsa sektori i industrisë nxjerrëse ka përqindjen më të ulët të investimeve prej 2.2 %.

Ndërmarrjet aktive sipas aktivitetit ekonomik 2020



Tre treguesit kryesorë të NVM-ve në Shqipëri krahasuar me BE-në janë:

- përqindja e NVM-ve është 99.8 %, i njëjtë me BE-në;

- përqindja e të punësuarve në këtë grup ndërmarrjesh është 81.6 % në Shqipëri nga 66.7 % në BE;
- vlera e shtuar e realizuar nga NVM në Shqipëri përbën 72.4 % nga 56.5 % në BE (tabela e mëposhtme).

Struktura e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes në Shqipëri dhe BE, 2019

Tab.2 Struktura e treguesve kryesorë sipas madhësisë së ndërmarrjes në Shqipëri dhe BE, 2019

Madhësia e ndërmarrjes	Ndërmarrjet (%)		Të punësuarit (%)		Vlera Shtuar (%)	
	Shqipëri	BE *	Shqipëri	BE*	Shqipëri	BE*
Gjithsej	100	100	100	100	100	100
NVM (1-249 të punësuar)	99,8	99,8	81,6	66,7	72,4	56,5
Mikrondërmarrje (1-9 të punësuar)	93,1	93,1	37,0	29,9	22,5	21,0
Nd. Vogla (10-49 të punësuar)	5,5	5,8	21,6	20,0	24,6	17,5
Nd. Mesme (50-249 të punësuar)	1,2	0,9	23,0	16,7	25,3	17,9
Nd. Madha (250+ të punësuar)	0,2	0,2	18,4	33,3	27,6	43,5

*28 vendet e BE-së

Shënim: Të dhënat mbi NVM-të për vendet e BE-së konsiderohen si paraprake pasi janë në proces revizionimi.

3.4.2. Tregtia e jashtme e mallrave në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), 2019:

- 3.1 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme eksportojnë mallra nga 2.5 % që eksportuan në vitin 2018.
- Vlera e eksporteve të mallrave të NVM-ve përbën 59.4 % të vlerës së eksporteve gjithsej.
- Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të ndërmarrjeve eksportuese është industria nxjerrëse me 23.7 %.
- 10.8 % e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme janë importuese nga 8.8 % që ishin në 2018, të cilat përbënë 78 % të vlerës së importeve të mallrave për 2019.
- Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, sektori me përqindjen më të lartë të numrit të ndërmarrjeve importuese është sektori i industrisë nxjerrëse me 24.2 %.
- Rreth 9.8 % e shitjeve neto të NVM-ve shkojnë për eksport.
- Ndërmarrjet e mesme kryejnë përqindjen më të lartë të eksporteve me 17.8 % të shitjeve neto të realizuara prej tyre.
- Mikrondërmarrjet eksportojnë vlerën më të ulët ku rreth 3.8 % të shitjeve neto janë eksportuar.

3.4.3. Struktura e punësimit sipas aktivitetit ekonomik, 2019

Mikrondërmarrjet kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e akomodimit dhe shër-

bimit ushqimor me 66,7 %. Ndërmarrjet e vogla kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e ndërtimit me 30,4 %. Ndërmarrjet e mesme kanë përqindjen më të lartë të punësimit në sektorin e industrisë përpunuese me 37,6 % (figura më poshtë).

3.4.4. Fondet dhe aksesimi në financë

Për vitin 2020 fondet që menaxhoheshin nga AIDA u administruan direkt nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe u shpërndanë në formën e skemave mbështetëse të përgatitura nga Qeveria për shkak të situatës së shkaktuar nga COVID-19. Në zbatim të Aktit Normativ nr. 15, datë 15.04.2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 88/ 2019, "Për buxhetin e vitit 2020", të ndryshuar, udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", udhëzimit plotësues nr. 2, datë 20.01.2020 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020".

AIDA, së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, krijuan grupin e punës për hartimin e skemës së re të mbështetjes financiare për NVM-të shqiptare. Për të ndihmuar këtë proces, grupi i punës u asistua edhe nga një mision i TAEX, ekspertët e të cilit zhvilluan takime me grupin, ndanë ide dhe informacion si dhe dhanë rekomandime mbi skemat e reja. Grupi i punës, pas rekomandimeve të misionit të TAEX, si dhe bazuar në feedback-un e marrë ndër vite nga NVM-të, arriti të finalizonte draftin e parë mbi rikonceptimin e fondeve të AIDA-s dhe krijimit

procesin e hyrjes në fuqi nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

3.4.5. Realizime gjatë vitit 2020

Vizita monitoruese pranë kompanive përfituese të fondeve të disbursuara deri në vitin 2019, respektivisht në qytetet: Tiranë, Shkodër, Kukës, Rrëshen dhe Vau i Dejës,

- Përditësimi dhe shtimi i profileve të kompanive në platformën online B2B në webin e AIDA-s. Në këtë platformë janë në total 740 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e tyre ndaj partnerëve potencialë për bërjen e biznesit brenda dhe jashtë vendit.
- U ndërmor një fushatë për promovimin e produkteve "Made in Albania". Në bazë të interesit të lartë të shprehur nga vetë kompanitë, por edhe bizneseve të kontaktuar nga stafi i AIDA-s është bërë identifikimi i produkteve vendase për fushatën "Zgjidh të Vendit" dhe përshkrimi i tyre.
- U organizua një forum diskutimi me temë "Promovimi i produkteve lokale dhe forcimin e markës Made in Albania" në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, në vijim të nismës promovim i produkteve "Made in Albania".
- U zhvillua forumi i dytë me temë "Politikat e Aksesit në Financë dhe rolin që ato kanë për mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare", në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në vijim të forumit të parë. Ky forum kishte si qëllim diskutimin me përfaqësues të sektorit privat dhe sektorit financiar për qasje të reja në financë dhe në mbështetje dhe promovim të produkteve shqiptare.
- U hartua pyetësori për nevojat për trajnim të NVM-ve shqiptare, si përgjigje ndaj situatës së krijuar nga COVID-19. Në fazën e parë, u identifikua dhe u përgatit një listë me 150 kompani të cilave u dërgua pyetësori. Në fazën e dytë dhe të fundit, u krye analiza e rezultateve nga stafi i drejtorisë dhe hartimi i një dokumenti me përfundime dhe rekomandime.
- U komunikua në mënyrë të vazhdueshme me SME-të, për informimin në lidhje me masat e ndërmarra nga Qeveria për përballimin e situatës së shkaktuar nga virusi Covid-19, si edhe për t'i asistuar në rast të shfaqjes së problemeve.

- U krijua rubrika e dedikuar Covid-19 në faqen web të AIDA-s me qëllim informimin e vazhdueshëm të SME-ve për situatën dhe masat e ndërmarra nga Qeveria në mbështetje të biznesit, furnizoi këtë rubrikë gjatë vitit 2020 me informacionet më të fundit.
- U krijua dhe përditësua në mënyrë periodike databaza me thirrje për aplikim lidhur me SME-të, në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia.
- U krijua dhe përditësua në mënyrë periodike databaza me trajnime dhe webinarë të dedikuara për NVM-të, në përgjigje të situatës së krijuar nga pandemia.
- U përditësuan dhe u shtuan 15 sektorë, në databazat me kontaktet e NVM-ve shqiptare,
- U dha kontribut dhe u punua në grup, në bashkëpunim me BERZH dhe MFE, për krijimin e platformës "Akses në Financë", me qëllim ndihmën ndaj digjitalizimit të NVM-ve shqiptare.
- U krijua databaza me aktorë dhe palë të interesuara të fushës së inovacionit, për të lidhur bashkëpunime me AIDA-n.
- U identifikuan kompanitë shqiptare sipas sektorëve të kërkuar për zhvillimin e takimeve B2B në forumin e parë ndërkombëtar online me tematikë "China-CEEC Economic and Trade Match-making Conference and Chengdu Conference" dhe u bë njoftimi i tyre me e-mail.

Pjesëmarrje dhe kontribute në grupe institucionale pune në kuadër të SME-ve:

- Pjesëmarrje dhe ndjekje e procesit të hartimit dhe monitorimit të strategjisë së zhvillimit 2021 – 2027 më konkretisht "Nxitja e eksportit dhe ndërkombëtarizimi."
- Pjesëmarrje në trajnimin "Access to markets" për mënyrat si mund t'i ndihmojmë bizneset që të importojnë dhe të eksportojnë me lehtësi gjatë periudhës së pandemisë.
- U përgatit dhe përditësua materiali i Drejtorisë për faqen web të re të AIDA-s.
- U finalizua trajnimi "Menaxhimi i ciklit të projektit" organizuar nga ASPA dhe IOM.
- Pjesëmarrje e stafit të Drejtorisë në webinarin me temë "Agrobiznesi në Shqipëri: Nga certifikimet tek kontraktimi në bujqësi".
- Pjesëmarrje e drejtorisë NVM-ve & Projekte në trajnimin online "Market Research and Market Intelligence" të organizuar nga SIPPO.

- Pjesëmarrje në trajnimin online, për platformën CRM. Trajnim i organizuar nga SIPPO Albania, për procedurën e regjistrimit të profileve të kompanive në platformë.
- Pjesëmarrje në trajnimin online për Export & Promotion në kuadër të marketing analizë. Stafi i drejtorisë NVM & Projekte mori pjesë në trajnimin e parë të organizuar si bashkëpunim i TRIC network për marketing analizë, si edhe ndoqi një kurs tregëtor online për këtë modul.
- Pjesëmarrje në takimet e grupit ndërinstitucional të punës (GNPIE) dhe kontribut me raportim për finalizimin dhe validimin e LGA të kapitullit 20 "Ndërmarrjet dhe politikat industriale".
- Pjesëmarrje në takimet e grupit ndërinstitucional të punës (GNPIE) dhe kontribut me raportim për finalizimin dhe validimin e LGA të kapitullit 25 "Shkenca dhe kërkimi shkencor".
- Pjesëmarrje në takimin online për klusterat në Shqipëri dhe plotësimi i tabelës së rekomandimeve të klusterave për AIDA-n;
- Pjesëmarrje në takimet e grupit përgatitor për strategjinë e re të zhvillimit të biznesit BIDS 2021-2027, dhënie kontributi informues dhe financiar.
- Komente dhe rekomandime për "Legal Report SME law Amendaments" nga GIZ, lidhur me situatën aktuale të SME-ve në Shqipëri, në vitin 2020.
- Komente dhe sugjerime në kuadër të Focus Group mbi "Vlerësimi i mundësive për zhvillimin e klusterave në Shqipëri", projekt studi i financuar nga KE dhe mbështetur nga Kryeministria.
- Komente për analizën "Vlerësimi i zhvillimit të ekonomisë shqiptare, një direktivë veprimi" nga GIZ, lidhur me ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.
- Komente dhe sugjerime në raportin e ligjit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe projektligjit për mbështetje të sipërmarrjeve 'Start Up'.
- Raportime periodike Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi ecurinë e projektit EEN-Albania dhe FILA.
- Ndjekje e "Inception Report" në lidhje me nismën "digjitalizmi i SME-ve", mbështetur nga BERZH, Këshilli i Investimeve dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë

3.4.6. Platforma online B2B dhe CRM

Në platformën online B2B të faqes së AIDA-s, janë në total 740 profile të kompanive shqiptare, me qëllim vizibilitetin e kompanive ndaj partnerëve potencialë për bërjen e biznesit. Gjatë këtij viti u përditësuan dhe u shtuan informacione për profilet e kompanive, sipas formatit të ri në faqen e AIDA-s.

Në platformën online CRM janë 215 profile, për të menaxhuar bashkëveprimin e NVM-ve shqiptare me klientët aktualë dhe potencialë.

3.4.7. Nisma dhe fushata në kuadër të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Hartimi i pyetësorit mbi nevojat për trajnim të sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme

Në kuadër të fushatës me pyetësorë të ndërmarrë nga AIDA, Drejtoria NVM dhe Projekte mbi nevojat e bizneseve shqiptare për trajnime hartoi pyetësorin për nevojat për trajnim të NVM-ve shqiptare. Në fazën e parë, u identifikua dhe u përgatit një listë me 150 kompani që ju dërgua pyetësori. Në fazën e dytë dhe të fundit, u krye analiza e rezultateve nga stafi i drejtorisë dhe hartimi i një dokumenti me përfundime dhe rekomandime.

Hartimi i pyetësorit mbi problematikat dhe nevojat e sipërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë periudhës së pandemisë

AIDA ka patur komunikim të vazhdueshëm me SME-të, për informimin në lidhje me masat e ndërmarra nga Qeveria për përballimin e situatës së shkaktuar nga virusi Covid-19, si edhe për t'i asistuar në rast të shfaqjes së problemeve. Në kuadër të masave që AIDA ka ndërmarrë si pasojë e virusit Covid-19 ka përgatitur një pyetësor i cili në fazën e parë ju është drejtuar 150 NVM-ve, ku pyetësori është realizuar nëpërmjet telefonit, për të kuptuar sa më mirë problematikat dhe nevojat e tyre në këtë periudhë, si edhe për një shpërndarje sa më të mirë të burimeve.

Krijimi i Rubrikës COVID-19 – Me informacione të rëndësishme në ndihmë të sipërmarrjeve

Në webin e AIDA-s u krijua rubrika COVID-19

me qëllim informimin e vazhdueshëm të SME-ve mbi situatën dhe masat e ndërmarra nga Qeveria në mbështetje të biznesit. Kjo rubrikë u përditësua vazhdimisht gjatë vitit 2020 me informacionet më të fundit në ndihmë të bizneseve shqiptare. Gjithashtu, AIDA krijoi databazën e plotë me thirrje dhe trajnime lidhur me SME-të, gjatë periudhës së pandemisë.

3.4.8 Promovim i Produkteve “Made in Albania”

Në kuadër të pandemisë, prezantimi i produkteve “Made in Albania” shihet si një domosdoshmëri në tregun vendas. AIDA ndërmoi një fushatë për promovimin e këtyre produkteve. Në bazë të interesit të lartë të shprehur nga vetë kompanitë, por edhe biznese të kontaktuar nga stafi i AIDA-s është bërë identifikim i produkteve vendase për fushatën “Zgjidh të Vendit” dhe promovimi i tyre. Që prej muajit korrik ka filluar promovimi në rrjetet sociale të institucionit ku gjatë gjithë vitit janë realizuar 45 infografe për produktet lokale.

Në vijim të nismës promovim i produkteve “Made in Albania”, AIDA në bashkëpunim me Ministrinë e Financave organizoi një forum diskutimi me temë “Promovimi i produkteve lokale dhe forcimin e markës Made in Albania”. AIDA publikoi katalogun e parë të produkteve “Made in Albania” një nismë e domosdoshme për Shqipërinë, për markën e vendit dhe ndërmarrjet shqiptare. Si botim i parë, katalogu “Zgjidh të Vendit”, për periudhën korrik-dhjetor 2020, prezanton 45 kompani, dhe ku kryeson sektori i prodhimit të verës, i ndjekur nga artizanati dhe agropërpunimi.

3.4.9. Projekte të menaxhuara nga AIDA

3.4.9.1. Menaxhimi dhe zbatimi i projektit “Enterprise Europe Network”

Rrjeti European i Ndërmarrjeve (Enterprise Europe Network) është rrjeti më i madh në botë, i cili mbështet ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (SME's/NVM) me synim inovacionin dhe rritjen e tyre në shkallë ndërkombëtare.

Ky rrjet bashkëfinancohet nën programin COSME (Konkurrueshmëria e Ndërmarrjeve të

Vogla dhe të Mesme) një program i financuar nga Bashkimi European, i krijuar për të inkurajuar konkurrueshmërinë e ndërmarrjeve evropiane. Rrjeti është aktiv në më shumë se 60 vende të botës. AIDA, është partneri kryesor udhëheqës i Konsorciumit Shqiptar të Enterprise Europe Network, i cili përbëhet në total nga 4 partnerë:

- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë (CCIT)
- Insituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen (IPPM)
- Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)

Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2020 janë realizuar :

- Takime periodike online me partnerët e Konsorciumit, koordinimi i Konsorciumit, pjesëmarrje në trajnime online, janë bashkëorganizuar aktivitete me qëllim arritjen e rezultateve të projektit.
- Për shkak të pandemisë globale, aktivitetet fizike u orientuan online dhe komunikimi me NVM-të përgjithësisht u zhvillua në distancë, së bashku me trajnimet dhe pjesëmarrjet në aktivitete të partnerëve të huaj të Rrjetit dhe Agjencisë EASME.
- U përgatitën 25 profile të reja të kompanive shqiptare.
- U realizuan 40 shprehje interesi të ardhura për lidhje të reja nga kompani të huaja dhe 252 kërkesa të bëra për partnerët e huaj, në emër të kompanive shqiptare.

Marrëveshje Partneriteti- u lidhën 3 kontrata të reja, përkatësisht me:

- “NPA Plast AB Sweden” me kompaninë “Shtypshkronja”
- “FG Walk” dhe kompanisë gjermane “Company 15”
- “Dress for Success”, Serbia me subjektin “Ambra Dodaj”
- AIDA - Marrëveshje bashkëpunimi me EEN - Kosovë

Marrëveshje Bashkëpunimi

AIDA, në cilësinë e koordinatorit të Enterprise Europe Network- Albania (EEN - Albania), në nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Enterprise Europe Network -Kosovë (EEN-Kosovo). Përmes kësaj marrëveshje EEN- Albania dhe EEN- Kosovë do të bashkëpunojnë në kuadër të implementimit të aktiviteteve specifike si: Mbështetje dhe shërbime këshillimi për sipërmarrjet e të dy vendeve, koordinim i shërbimeve profesionale individuale për sipërmarrjet SME, si edhe ofrimi i aksesit për të gjetur partnerë të mundshëm biznesi në të dy vendet, bashkëpunim dhe organizim i aktiviteteve të ndërmjetësimit, misionëve të biznesit, panai-reve, si edhe aktiviteteve informuese për të lehtësuar bërjen e biznesit ndërkombëtar, rritjen e inovacionit dhe teknologjisë.

AIDA, në cilësinë e koordinatorit të Enterprise Europe Network- Albania (EEN - Albania), nënshkroi një marrëveshje bashkëpunimi me Dhomën Ekonomike të Grave të Shqipërisë. Kjo marrëveshje ka si qëllim bashkëpunimin mes palëve për përmirësimin e klimës së biznesit, përmirësimin e shërbimit ndaj grave sipërmarrëse shqiptare nëpërmjet shtimit dhe përqendrimit të shërbimeve publike në selinë e Dhomës duke synuar rritjen dhe zgjerimin e biznesit, si dhe inkujimin e sipërmarrjeve nga gratë në Shqipëri.

Në kuadër të zbatimit të projektit, AIDA ka qenë bashkorganizatore edhe në 13 evente ndërkombëtare të zhvilluara online, si:

- U organizuan dy 'conference calls' për projektin EEN, një konferencë me EASME- Bruksel dhe një me EEN Kosovo.
- U organizua takimi dhe nënshkrimi i MoU midis EEN – Kosovo dhe EEN – Albania.
- U organizuan 4 sesione trajnimi, në kuadër të procesit të mentorimit të EEN – Kosovo.
- Pjesëmarrje në trajnimin 2-ditor organizuar nga SG Textile/EASME dhe Improve Academy mbi temën "Sustainability of Innovation Driven Management Tools".
- Pjesëmarrje në SAG meeting – takim i nivelit të lartë drejtues të drejtuesve të EEN në Europë dhe vendet anëtare në COSME.
- Pjesëmarrje në akademinë verore të SME-ve dhe prezantimi i projektit Enterprise Europe Network.

3.4.9.2. Menaxhimi dhe zbatimi i projektit 'FILA'

Projekti "FILA" bashkëfinancohet nga BE dhe zbatohet në kuadër të programit ndërkufitar Interreg IPA Itali-Shqipëri-Mal i Zi, për një periudhë 2-vjeçare 01.04.2018 – 01.04.2020, por për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19 kohëzgjatja e projektit u shty deri në 01.01.2021. Objektivi kryesor i tij është rritja e konkurrueshmërisë së NVM-ve dhe bashkëpunimit ndërkufitar duke forcuar lidhjen ndërmjet kërkimit dhe bizneseve përmes krijimit të tre laboratorëve ndërkufitarë të fertilizimit dhe inovacionit në sektorin agroushqimor në Shqipëri (Korçë), Mali i Zi (Niksic-Tehnopolis) dhe Puglia (Bari - CIHEAM) bazuar në modelin FILA.

Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit 2020 janë realizuar:

- Tre raportime për projektin FILA në platformën EMS, sipas planit të parashikuar në projekt;
- Komunikim i vazhdueshëm me partnerët e projektit "FILA" për ndryshimet e ndodhura në projekt. Firmosja e Statement & State Aid Declaration midis Lead Partner (LP) - Project Partner (PP), për buxhetin e ri, pas largimit të njërit prej partnerëve nga projekti;
- Komunikim me pikat e kontaktit të "Info Point" për informacion të azhurnuar mbi gjendjen aktuale të projektit FILA. Konkretisht të problemeve në moskalimin e fondit nga Banka e Shqipërisë, në llogarinë e nivelit të dytë të projektit, çfarë hapash kemi ndërmarrë dhe në cilën fazë jemi;
- Komunikimi me Lead Partner të projektit për firmosjen e marrëveshjes së re për AIDA-n nga Drejtori Ekzekutiv, me ndryshimet e ndodhura si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19;
- Organizimi i mbledhjes Consortium Meeting midis partnerëve në skype, për periudhën e katërt, për projektin FILA;
- Menaxhimi i rrjeteve sociale të projektit "FILA" dhe rritja e vizibilitetit të tij gjatë vitit 2020;
- Organizimi i mbledhjes midis partnerëve në skype, për procedurën e raportimit dhe hapat që duhet të ndërmarrim në fund të projektit, për projektin FILA;
- Bashkëpunimi me partnerët e projektit në

Shqipëri për sigurimin e kontakteve të kompanive Start Up, për t'u përfshirë në trajnime në kuadër të projektit FILA;

- Plotësimi i pyetësorit për çdo partner pjesëmarrës në projekt, "Evaluation of selected project achievements";
- Zhvillimi i mbledhjes online me partnerët e projektit për ndjekjen e aktiviteteve të parashikuara në projekt, zhvillimin e intervistave dhe hartimi i një dokumenti politikash;
- Bashkërendimi i punës me partneret e projektit dhe publikimi në rrjetet sociale të projektit FILA, të gjithë aktiviteteve të zhvilluara;
- Pjesëmarrje në Crossborder Community of Practise meeting midis partnerëve të projektit;
- Pjesëmarrje në eventin final: "European Innovation Partnership: Comparing Experiences of the Regions and Perspectives for the Programming 2021-2027";
- Pjesëmarrje në takimin final Consortium meeting and Steering committee.

3.4.9.3. Aplikime në Projekte

Një ndër funksionet dhe objektivat e AIDA-s është identifikimi dhe aplikimi në projekte me donatorë (vendas ose të huaj), me qëllim mbështetjen e politikave të AIDA-s në fushën e mbështetjes së biznesit vendas.

Në kuadër të këtij objekti gjatë vitit 2020 janë realizuar:

- Identifikimi i thirrjeve të hapura ku AIDA ka qenë "eligible" për të aplikuar, si dhe përvetësimi i guidave të kriterëve për secilën thirrje.
- Pjesëmarrje në takimin informues për thirrjen e IPA III CBC.
- U realizua kërkim për thirrjen "European advanced manufacturing assistance and training for SMEs".
- U plotësuan draft fishat për programin IPA III, në fushën konkurrueshmëria dhe inovacioni. Në kuadër të programit IPA III, fusha e konkurrueshmërisë dhe inovacionit, ku secili vend duhet të aplikonte për të fituar projekte; AIDA ka plotësuar një draft fishë nën emërtimin: "Improve Micro Small and Medium Enterprises Access to finance and establishment of a Lab/Incubator." Kjo draft fishë, u bashkua në një të vetme me draft fishat e përgatitura nga MFE dhe institucionet e tjera të varësisë.
- U punua për aplikimin në 2 projekte paralele, ku AIDA u përfshi si partner në Konsorcium. Të dy projekt aplikimet u bënë në programin COSME dhe do të kenë fokus digjitalizimin e sektorit të turizmit. Projekt aplikimi i parë me titull "DIGI-TOUREU" dhe projekti aplikimi i dytë me titull "Digi-Tourism". Vendimi për këto projekt aplikime do të jepet në mes të vitit 2021.

4 DREJTORIA MARKETING DHE KËRKIM ANALIZË

4.1. Hyrje

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë ka për funksion sigurimin e Komunikimit dhe Marketingut të institucionit për politikën, prioritetet, aktivitetet, fushatat etj. Po ashtu, kjo drejtori ka për funksion kërkim dhe analizën në lidhje me variabla të ndryshme që AIDA i ka në fokus t'i mbulojë në përmbushje të ligjit të saj organik. Misioni i Drejtorisë Marketing dhe Kërkim Analizë është arritja e objektivit mbi informacionet

mbi tregun dhe strategjive të reja, me qëllim kërkimin në vazhdimësi për mundësi të reja investimi në Shqipëri.

Drejtorja Marketing dhe Kërkim Analizë siguron informacione mbi tregun dhe strategjitë e reja, kryen studime tregu dhe kërkim të dhënash me qëllim përditësimin e materialeve dhe informacioneve në funksion të drejtorive dhe investitorëve.

Drejtoria e Marketing dhe Kërkim Analizë në mbështetje të drejtorive të tjera të Agjencisë, përgjatë vitit 2020 krahas rritjes së kanaleve të komunikimit, përmirësoi përmbajtjen dhe cilësinë e komunikimit.

4.2. Publikime në media sociale

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka mundësuar funksionimin e pandërprerë, përditësimin me informacion, si edhe pasqyrimin në kohë të tij, në të gjitha kanalet e komunikimit (website, facebook, instagram, twitter). Pasqyrimi i të gjitha aktiviteteve, takimeve zyrtare, konferencave, trajnimeve etj. është pasqyruar në faqen Web dhe në Rrjetet Sociale nëpërmjet shkrimit të një lajmi në gjuhën shqipe dhe angleze, si edhe shoqërimit me foto, video, infograf ilustruese etj. Të gjitha postimet në rrjetet sociale janë të shoqëruara me linqe nga faqja zyrtare e AIDA-s, në mënyrë që të promovohet faqja zyrtare e institucionit, si edhe për ta bërë më të aksesueshme nga publiku.

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka ndjekur dhe monitoruar të gjitha informacionet mbi veprimtarinë e AIDA-s, grupeve të interesit, investorëve, partnerëve etj., dhe ka informuar publikun e gjerë nëpërmjet mediave elektronike dhe faqes zyrtare www.aida.gov.al në kohë reale. Një rëndësi të veçantë i është kushtuar organizimit të aktiviteteve dhe përmirësimit të imazhit duke siguruar që të dhënat, lajmet dhe materialet promovuese të Agjencisë të shpërndahen në mënyrë periodike nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes zyrtare të internetit.

AIDA Website

Webi i AIDA-s, përmban informacione të dobishme në ndihmë të investorëve, kompanive vendase, si edhe ato të huaja. Website i ri përmban rubrikat kryesore me kategorizime përkatëse, të cilat ju përshtaten karakteristikave të audiencës. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë është angazhuar në menaxhimin dhe përditësimin e përmbajtjes së faqes zyrtare të webit të Agjencisë, www.aida.gov.al, kontenti i së cilës ofrohet në gjuhën shqipe dhe angleze. Përditësimi i faqes zyrtare bëhet në baza të rregullta duke reflektuar praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe nëpërmjet një marketingu miks synon tërheqjen e një numri në rritje të in-

vestitorëve potencialë për të vizituar faqen.

Faqja zyrtare AIDAs, së bashku me rrjetet sociale (facebook, twitter, instagram) kanë qenë shumë aktive dhe një asistencë e rëndësishme për të gjithë aktorët dhe bizneset të cilët vizitojnë faqen zyrtare dhe rrjetet sociale të AIDA-s për tu njohur në kohë reale me të gjitha informacionet e pasqyruara. Në total në të gjitha adresat e AIDA janë 506 postime.

AIDA Facebook

Faqja e facebook ka një audiencë të lartë, numër i cili ka ardhur duke u rritur vazhdimisht që prej krijimit të faqes në vitin 2016. Faqja facebook përditësohet vazhdimisht duke ofruar informacione mbi aktivitetet e ardhshme dhe të zhvilluara, mbi investimet dhe klimën e të bërit biznes, rritjen ekonomike etj. Për vitin 2020 janë bërë 259 lajme dhe share gjithsej.

AIDA Twitter

AIDA është aktive edhe në rrjetin social twitter duke publikuar dhe ndarë me ndjekësit informacione të rëndësishme në dobi të gjithë palëve të interesuara. Për vitin 2020, janë bërë 37 postime gjithsej.

AIDA Instagram

Profil i ri i AIDA-s në instagram u krijua përgjatë vitit 2019, duke krijuar një rritje të palëve të interesuara dhe njohje nga një masë me e gjerë e shërbimeve dhe rolit të institucionit. Për vitin 2020 janë bërë gjithsej 165 publikime të aktiviteteve/lajmeve më të rëndësishme.

Formatet Video

Përgjatë vitit 2020 AIDA ka publikuar 9 video të cilat trajtojnë ndarje eksperiencash mbi mënyrën e të bërit biznes në Shqipëri, shembuj investimesh të suksesshme, të cilat shoqëruan aktivitete të veprimtarisë së AIDA-s etj. Vizitat pranë Kantina Çobo dhe Kantina Nurellari, Berat u zhvilluan në kuadër të njohjes së problemeve të sektorit të agroturizmit në vend dhe për promovimin e këtij sektori kyç dhe rolit që ka në zhvillimin e turizmit dhe ekonomisë vendase. Gjithashtu, në kuadër të monitorimit të fondeve AIDA zhvilloi takime në punishten e përpunimit të qumështit Hysa, pastičeri "Marku", AN&GES Shpk, Madish Shpk.

- Video mbi fushatën promovuese të AIDA-s #eduashqip
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/992020507982440>
- Kantina Çobo, Berat
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/663982591172258>
- Kantina Nurellari, Berat
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/327074645237877>
- Punishtja e përpunimit të qumështit "Hysa" përfitues i Fondit nga AIDA.
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/646462379368331>
- Pastigjeri "Marku", përfitues i Fondit nga AIDA
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/365121304717293>
- AN&GES - Përfitues i fondit të Konkurrueshmërisë të AIDA-s
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/3493512987402462>
- Vizita e AIDA-s në kompaninë "Innovaway Albania". AIDA ka qenë kontakti i parë për "Innovaway", duke shërbyer si urë lidhëse

mes kompanisë e Qeverisë
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/184152410072294>

- Kompania Madish - Përfitues i Fondit të Inovacionit nga AIDA
<https://www.facebook.com/269159649825807/videos/402526630947872>

4.3. Botimi dhe dizenjimi i materialeve promovuese

AIDA, gjatë vitit 2020 në kuadër të rritjes së vizibilitetit dhe informimit dizenjoji dhe hartoi materiale promovuese (digjitale dhe fizike) të cilat shërbejnë për informimin e investorëve potencialë dhe ekzistues si edhe promovimin e veprimtarisë së AIDA-s në aktivitetet pjesëmarrëse. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë në bashkëpunim me drejtoritë e tjera siguroi përditësimin e materialeve marketing dhe u kujdes për botimin dhe vendosjen e tyre në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë. Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë gjatë vitit 2020 pati në fokus zhvillimin dhe përgatitjen e marketingut dhe shërbimeve të nevojshme në mbështetje të drejtorive të tjera. Një rëndësi ju kushtua cilësisë përmbajtjes së informacionit të materialeve promovuese si dhe plotësimit të kërkesave të legjislacionit në fushën e botimit.



FACTSHEET

**Agriculture, Agrotourism
and Aquaculture Sector**



Broshura "FactSheet Sektori i Agrikulturës dhe agroturizmit"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/615-sektori-i-agrikultures-agroturizmit-dhe-akuakultures>

Botimi pëmban një pasqyrë të Sektorit të Agrikulturës dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



Tourism Sector



Broshura "FactSheet Sektori i Turizmit"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/589-sektori-i-turizmit-2>

Botimi përmban një pasqyrë të Sektorit të Turizmit në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



MANUFACTURE Sector



Broshura "FactSheet: Sektori i Manufakturës"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/582-sektori-i-manifaktures>

Botimi përmban një pasqyrë të Sektorit të Manufakturës në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



ICT and BPO Sector



Broshura "FactSheet Sektori i ICT dhe BPO"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/583-sektori-ict-dhe-bpo>

Botimi përmban një pasqyrë të Sektorit të ICT dhe BPO në Shqipëri dhe incentivat e qeverisë për investimet në këtë sektor.



Renewable Energy Sector



Broshura "FactSheet Sektori i Energjisë"

<https://aida.gov.al/images/PDF/Publikime/Energy-FactSheet.pdf>


Botimi përmban një pasqyrë të sektorit të Energjisë dhe nënsektorët e tij në Shqipëri, incentivat e qeverisë dhe informacion mbi marrjen e statusit të Investitorit Strategjik në këtë sektor.



Botim Statistikor - Fondet AIDA 2014 – 2019

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/761-botim-statistikor-mbi-skemat-e-financimit-te-menaxhuara-nga-aida-2014-2019>

Ky botim statistikor përmban të dhëna, nga viti 2014-2019, për ecurinë dhe zbatimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA. Në të jepen shifra konkrete të buxhetit, aplikimeve dhe përfituesve, gjithashtu, gjenden edhe analiza të të dhënave, me qëllim pasqyrimin e impaktit të këtyre politikave në mjedisin ekonomik dhe atë të bërjes biznes nga ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare.



Broshura "Albania Calls - A country of opportunities 2020"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/619-albania-calls-a-country-of-opportunities-2020>


Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione të vlefshme mbi arsyet kryesore pse duhet të investosh në Shqipëri si edhe të dhëna mbi klimën e të bërit biznes në Shqipëri. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme e kësaj broshure janë edhe informacionet mbi incentivat në sektorët kryesorë të investimeve në Shqipëri si: Energjia, Turizimi, Bujqësia, Manifaktura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA) të shoqëruara me pamje të pikave turistike në Shqipëri.



Broshura "Invest in Albania 2020"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/618-invest-in-albania-2020>

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione me të dhëna statistikore për Shqipërinë dhe ekonominë, pesë arsyt pse të investosh në Shqipëri, Investimet e Huaja Direkte, Ligjin e Investimeve të Huaja, procedurat e për statusin e investitorit strategjik si edhe incentivat për investimet strategjike. Pjesë e kësaj broshure është edhe informacioni mbi funksionin dhe misionin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve.



Broshura "Bring your Business in Albania 2020"

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/617-bring-your-business-in-albania-2020>

Ky botim në gjuhën angleze përmban informacione mbi arsyt pse të investosh në Shqipëri, ligjin mbi investimet strategjike dhe investimet e huaja si edhe incentivat për sektorët me potencial zhvillimi si: Energjia, Turizmi, Agroturizmi, Manifaktura, Agrikultura dhe Zonat e Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik (TEDA). Ky botim i AIDA-s i drejtohet të gjithë investitorëve potencialë dhe prezanton lehtësirat e të bërit biznes në Shqipëri.



Broshura Manualit i Investimeve Strategjike

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/611-manuali-i-investimeve-strategjike>

Në këtë botim onilne të broshurës, investitorët shqiptarë dhe të huaj të interesuar për të bërë biznes në Shqipëri, do të gjejnë të gjithë informacionin mbi legjislacionin shqiptar të investimeve strategjike, sektorët strategjikë, aplikimi për statusin e investitorit strategjikë, procedurat administrative të investimeve strategjike, organet ligj zbatuese, bashkëpunimet ndërinstitucionale për vënien në zbatim të projektit dhe marrjen e statusit të investitorit strategjik.



Newsletter Elektronik numër 1, 2, 3 dhe 4 për vitin 2020

- <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/836-newsletter-2020-tetor-dhjetor>
- <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/614-newsletter-2020-korrik-shtator>
- <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/612-newsletter-2020-prill-qershor>
- <https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/610-newsletter-2020-janar-mars>

Botimet e Newsletters shërbejnë si një kornizë pasqyrimi për të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë vitit 2020. Publikimi i newsletter-it ka si synim të rrisë ndërveprimin e AIDA-s me partnerët, bashkëpunëtorët dhe aktorët e interesit.

Botimi leaflet "Helping ambitious SME's innovate and grow internationally" mbi mundësitë dhe shërbimet e integruara që EEN-Albania ofron për NVM-të

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/613-helping-ambitious-smes-innovate-and-grow-internationally>

Ky botim përmban një përmbledhje me informacione mbi mundësitë dhe shërbimet e integruara që EEN-Albania ofron për sipërmarrjet e vogla dhe të mesme, me synim rritjen e aftësive konkurruese dhe inovative, si edhe krijimin e partneriteteve të reja në tregun europian e më gjerë.



Enjoy Bio Albania

<https://www.aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/607-sektori-i-bimeve-aromatike-dhe-medicinale-ne-shqiperi>

Në këtë botim do të gjeni një informacion të përgjithshëm mbi zhvillimin e sektorit të bimëve aromatike dhe medicinale në Shqipëri, incentivat dhe ndihmën e AIDA-s në mbështetje të këtij sektori. Gjithashtu, pjesë e broshurës janë edhe kompanitë që ishin pjesëmarrëse në panairin Biofach, në Nurenberg, Gjermani.





Katalogu i produkteve "Made in Albania" për periudhën Korrik-Dhjetor 2020

<https://aida.gov.al/sq/te-reja-publikime/publikime/832-katalogu-i-pare-i-produkteve-made-in-albania?fbclid=IwAR1vAUoPxiTl-HzgXuNtmrXucKnS7Ax368er1PB7VseSpS-Rh-QeDSTwuaQqs>

4.4. Transparenca e Informacionit

Drejtoria Marketing dhe Kërkim Analizë ka bërë monitorimin paraprak dhe konstatues në baza ditore, të përmbajtjes së çdo e-maili të ardhur në adresën zyrtare të agjencisë info@aida.gov.al. Për vitin 2020, në adresën info@aida.gov.al kanë ardhur 375 e-maile për kërkesë informacioni, të cilat pasi janë shqyrtuar dhe hartuar informacioni i nevojshëm ju është dërguar kthim-përgjigjja brenda afateve të përcaktuara të rregullores. Për të gjitha eventet dhe aktivitetet ku AIDA ka marrë pjesë ose ka organizuar janë informuar me e-maile sipërmarrjet shqiptare sipas databazës që disponohet. Në përputhje edhe me programin e transparencës të miratuar, AIDA ka vendosur në dispozicion të publikut në faqen e internetit www.aida.gov.al të gjitha kategoritë e informacionit publik pa kërkesë në menunë AIDA/ Baza Ligjore AIDA - Programi i Transparencës.

5 AIDA NË AKTIVITETE

5.1. Pjesëmarrja dhe Organizimi i Aktiviteteve

5.1.1. Aktivitete lokale me qëllim mbështetje dhe informim të biznesit

Agjencia, në funksion të veprimtarisë së saj, ndërmerr të gjitha nismat e nevojshme në mbështetje të zhvillimit të sektorit privat dhe të përmirësimit të klimës së biznesit, duke ndjekur dhe ndihmuar subjektet tregtare private në të gjitha fazat e veprimtarisë së tyre ekonomike, si dhe duke ndërmjetësuar e bashkëpunuar me organet shtetërore. Agjencia, me qëllim fuqizimin dhe rritjen e aftësive konkurruese të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, siguron të dhë-

na të nevojshme për bizneset dhe mundëson përhapjen e tyre, nëpërmjet ndërtimit të një rrjeti shkëmbimi të informacioneve.

Përgjatë këtij viti AIDA ka organizuar në mënyrë të vazhdueshme aktivitete, seminare informuese dhe takime door to door me bizneset, me qëllim informimin e tyre mbi shërbimet kryesore që AIDA ofron.

Seminaret informuese, (info day) u organizuan në qarkun e Gjirokastrës dhe ishin parashikuar të realizoheshin dhe në qytete të tjera, si: Erseka, Shkodra, Vlora por u anuluan për shkak të situatës së krijuar nga virusi COVID-19.

Gjithashtu, u realizuan takime "Door to Door"

në kompaninë “Dorgjani Shpk”, në qytetin e Kukësit, në kompanitë: Madish, AN&GES, Melkans, Rudaj Plast dhe ambientet e Hysni Brahimi PF dhe Fabiola Marku PF në qytetin e Shkodrës, si edhe në kompanitë Wine AL, Stella Shpk në qytetin e Durrësit.

5.1.2. Panairot, dhe roli i AIDA-s në mbështetjen ndaj bizneseve

Pjesëmarrja e bizneseve shqiptare në panaire jashtë vendit është një mbështetje e veçantë në përpjekjet e qeverisë shqiptare, nëpërmjet AIDA-s për të nxitur biznesin vendas dhe veçanërisht atë eksportues. AIDA nëpërmjet mbështetjes apo organizimit të pjesëmarrjes në panaire synon promovimin e biznesit shqiptar në sektorë specifikë, mundësimin e takimeve me kompanitë e interesuara për partneritet dhe mbështetjen e kompanive shqiptare me logjistikë për takimet e planifikuara, rritjen e eksportit në këtë sektor, tërheqjen e investitorëve të huaj për investime në vend dhe promovimin e Shqipërisë. Nëpërmjet pjesëmarrjes në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare, AIDA promovon produktet dhe shërbimet shqiptare në tregjet ndërkombëtare, për të reklamuar dhe për të lehtësuar eksportin e produkteve “Made in Albania”.

Panaire 2020

Panairi “Biofach 2020”, i bimëve medicinale dhe ushqimit organik, në Nurenberg, datë 12-15 shkurt 2020.

AIDA mundësoi që 5 kompani shqiptare (Albanian Herb, Albfruit 2005, Bidaj, Bioalba Group, BioBes) të kishin stendë të dedikuara në pavilionin e përbashkët të Shqipërisë. AIDA në këtë organizim bashkëpunoi me partnerët SIPPO dhe RISI Albania, të cilët asistuan stafin e AIDA-s dhe 5 kompanitë pjesëmarrëse. Në kuadër të pjesëmarrjes, në këtë panair, u përgatit broshura “Enjoy Bio Albania”, e cila përmbante informacion mbi zhvillimin e sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike në Shqipëri, si edhe informacion të përgjithshëm për 5 kompanitë pjesëmarrëse në panair.

Përgjatë 2020 nuk janë zhvilluar panaire të tjera për shkak të masave të marra për parandalimin e COVID-19.

5.2. Bashkëpunime dhe partneritete të realizuara në kuadër të SME-ve dhe projekteve

- 13-14 janar 2020, u zhvilluan takime në kuadër të përgatitjeve për pjesëmarrjen në panairin kryesor të Tregtisë Botërore për Ushqimin Organik “BIOFACH”, AIDA në bashkëpunim me SIPPO dhe Risi Albania (projekt i SDC-së). Në këtë sesion përgatitor ishin prezente edhe 5 kompani shqiptare të sektorit të bimëve medicinale dhe aromatike, të cilat ishin pjesëmarrëse në panairin BIOFACH;
- 16-18 janar 2020, u zhvillua në Tiranë “Samiti i Grave të Biznesit”. Në këtë samit ishin të pranishëm përfaqësues nga AIDA në kuadër të fondeve që AIDA menaxhon, ku një prej fondeve specifikisht, fondi i artizanatit i dedikohej, kryesisht, grave sipërmarrëse, duke krijuar dhe hapësirat përkatëse për pjesëmarrje në panaire jashtë vendit. Për periudhën 2014-2019, nga 4 fondet aktive që ka menaxhuar AIDA, 38% e totalit të përfutuesve nga këto fonde ishin gra.
- 21 janar 2020, u zhvillua takim me CBS Solution, mbi fushat e bashkëpunimit ndërmjet AIDA-së dhe CBS, me qëllim forcimin e partneritetit dhe ngritjen e urave të reja të bashkëpunimit për mbështetjen e zhvillimit të biznesit të NVM-ve në vend. Gjatë takimit u diskutuan çështjet e interesit të përbashkët si dhe problematika konkrete të punës me biznesin, siç ishin ngritja e platformave online dhe mundësitë që ky rrjet ofron për kompanitë shqiptare në gjetjen e tregjeve dhe partnerëve ndërkombëtarë si dhe efienca e përdorimit të platformave digjitale për agrobiznesin, promovimin dhe asistencën për eksportuesit përmes pjesëmarrjes në panaire ndërkombëtare dhe që duhen ndjekur më pas nga sektori i NVM-ve dhe Eksporteve pranë AIDA-s;
- 22 janar 2020, pjesëmarrje në aktivitetin “Shqipëria në Horizon 2020 dhe perspektivat e së ardhmes”. Aktiviteti u zhvillua në formë “workshop”-i, dhe kishte tematikë kryesore mundësitë për të shkëmbyer dhe shpërndarë praktika në zbatimin dhe menaxhimin financiar të projekteve nën programin

Horizon 2020 dhe perspektiva për 2021-2027. Në këtë workshop, ishte i ftuar z. Bernhard Fabianek, Specialist për Politika-Marrëdhëniet R&I me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, Horizon Europe 2020, i cili ngrihti për diskutim mundësitë e ofruara për Shqipërinë në këtë projekt dhe jo vetëm; pikat e forta dhe të dobëta të aplikuesve në projekte dhe vetë projekteve të paraqitura; implementimin dhe suksesin e deritanishëm. Ai bëri thirrje motivuese mbi rritjen e kërkesës për projekte dhe mbi zhvillimet më të fundit.

- 27-28 janar 2020, u mbajt në Sofje, Bullgari, takimi mes Krerëve të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e inovacionit dhe bizneseve Start-Up. Kryefjala e këtij takimi ishte bashkëpunimi midis vendeve të Ballkanit Perëndimor për zhvillimin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme, me fokus inovacionin dhe bizneset Start-Up.
- 28-29 janar 2020, u realizua vizita studimore në Bruksel, në kuadër të projektit "Asistenca Teknike për Programet Evropiane në Shqipëri", me synim rritjen e kapaciteteve të Pikave Kombëtare të Kontaktit që koordinojnë Programet Evropiane, si dhe për të rritur nivelin e njohjes e ndarjes së eksperiencave me homologët në Bruksel dhe rrjete të ndryshme.
- 29 janar 2020, pjesëmarrje në takimin e 2-të të grupit kombëtar të punës të Rrjetit Intermodal dhe Aktivitetit Promovues.
- 30 janar 2020, u mbajt në Sofje, Bullgari forumi i biznesit me temë "Prezantimi i sipërmarrjeve të huaja/shqiptare për Biznesin Bullgar", i cili krijoi mundësinë e kontaktit të drejtpërdrejtë mes sipërmarrjeve bullgare dhe atyre shqiptare, për të shkëmbyer përvojat dhe vendosur partneritete të reja.
- 4 shkurt 2020, u realizua takimi me përfaqësuesit e OECD dhe SIDA në kuadër të fazës së parë të procesit për përgatitjen e Dokumentit të Strategjisë së Re Kombëtare, për Zhvillim dhe Integrim përtej 2020/ vizion 2030.
- 6 shkurt 2020, pjesëmarrje në workshop-in "Shqipëria: Vizioni dhe Sfidat 2030 dhe

konteksti i Strategjisë Kombëtare 2030", në bashkëpunim me Kryeministrinë, OECD, Agjencinë Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (SIDA). Ky aktivitet u konsiderua si faza e parë për përgatitjen e dokumentit të Strategjisë së Re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim, përtej 2020/ Vizionit 2030 për vendin.

- 11 shkurt 2020, u mbajt takim i parë në kuadër të programit IPA III për fushën "Konkurrueshmëria dhe Inovacioni" mbi plotësimin e formatit të Përgjigjes Strategjike për fondet IPA III.
- 24 shkurt 2020, pjesëmarrje në workshopin "Horizon 2020", ku u diskutuan problematikat dhe qasjet pozitive të pikave të kontaktit nga çdo institucion pjesëmarrës në Horizon 2020.
- U zhvillua takimi midis stafit të NVM-ve & Eksperte dhe Partners Albania për kalendarin e bashkëpunimit dhe problematikat e biznesit social.
- 26 shkurt 2020, pjesëmarrje në "Trajnim mbi platformën CRM", i zhvilluar pranë zyrave të AIDA-s nga bashkëpuntorët e SIPPO, për përdorimin dhe funksionimin e platformës.
- 27 shkurt 2020, u mbajt takimi me SIPPO dhe UN International Trade Centre ITC për vlerësimin e bashkëpunimit SIPPO Albania dhe AIDA.
- Pjesëmarrje në takimin online të "WS on Change Project/Proseed PSD 2020" me përfaqësues nga MFE dhe nga GIZ, me fokus rritjen e aftësive sipërmarrëse të themeluesve ose pronarëve të MSME-ve tashmë ekzistuese, të cilët dëshirojnë të zgjerojnë biznesin e tyre dhe të përmirësojnë konkurrencën e tyre si në tregjet kombëtare ashtu edhe në ato ndërkombëtare.
- Takim online me Drejtorin e OFICINA Innovation Hub, z. Arjan Ymeri, me qëllim informimin mbi qendrën e tyre dhe mundësitë për bashkëpunim midis AIDA dhe kësaj të fundit.
- Pjesëmarrje në takimin e zhvilluar online për

“Kapacitetet dhe aftësitë e sektorit privat për e-commerce” zhvilluar me përfaqësues të Bankës Botërore, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe institucione të tjera.

- 28-30 tetor 2020, pjesëmarrje në forumin e parë ndërkombëtar online me tematikë “China-CEEC Economic and Trade Match-making Conference and Chengdu Conference”.
- 2 nëntor 2020, organizim dhe pjesëmarrje në forum diskutimin “Aksesi në Financë Mbështetje për Produktet Shqiptare, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- Takim me përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale me qëllim shtrirjen e bashkëpunimit në disa aktivitete të përbashkëta në ndihmë të biznesit.
- Takim me përfaqësues të Agjencisë së Investimeve të Huaja dhe Promovimit të Eksportit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në takim u diskutua mbi mundësitë e tërheqjes së investimeve të huaja, organizimin e një Study Tour në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për të shkëmbyer përvojat dhe eksperiencat në tërheqjen e investimeve të huaja, si edhe rritjes së bashkëpunimit në projekte me ndikim në zhvillimin e Ballkanit Perëndimor.
- 26 qershor 2020, organizim i ceremonisë së inaugurimit të fabrikës Yura Corporation Albania

5.3. Webinare

Organizimi dhe zhvillimi i webinarëve:

- 21 maj 2020, AIDA në bashkëpunim me partnerin Expocity Albania zhvilloi webinarin me temë “Industria Tekstile në Shqipëri dhe dinamikat gjatë dhe pas COVID-19”. U diskutua mbi zgjidhje të reja alternative, pritshmëritë për të ardhmen, situatën e industrisë tekstile në tregjet ndërkombëtare, si edhe ndikimin që ka shkaktuar pandemia në mbarëvajtjen e sektorit.
- 9 korrik 2021, u zhvillua webinarin me temë: “Turizmi i së Ardhmes - Menaxhimi në kohë reale post COVID-19”. Në këtë webinar, u

veçuan hapat drejt rimëkëmbjes së industrisë së turizmit si dhe impaktin që kjo pandemi ka sjellë në Shqipëri dhe në Evropë si dhe masat e ndërmarra nga qeveria shqiptare për mbrojtjen e këtij sektori, impaktin në agjencitë turistike, hotelieri dhe udhëtimet ajrore dhe atë çfarë premton e ardhmja për këtë sektor.

- 16 Korrik 2020, u zhvillua webinarin me temë: “Eksportuesi i Miratuar”. Ekspertë pranë AIDA-s prezantuan tek eksportuesit shqiptarë informacionin për disa lehtësira që parashikon legjislacioni doganor në fushën e origjinës së mallrave dhe përfitimet që ka biznesi eksportues nga këto lehtësira.
- 30 korrik 2020 u zhvillua webinarin me temë: Ditë informuese EEN - Albania | Sipërmarrjet Shqiptare pjesë e familjes evropiane”. Ky webinar kishte si qëllim të informonte të gjitha bizneset shqiptare mbi mundësitë që Enterprise Europe Network (EEN - Albania) ofron për gjetjen e partnerëve të biznesit, zhvillimin e inovacionit dhe rritjen e konkurrueshmërisë në tregun evropian e më gjerë.
- 17 shtator 2020, u zhvillua webinarin me temë: “Guidë mbi grantet Europiane për SME-të”. Ky webinar kishte si qëllim informimin e bizneseve mikro, të vogla dhe të mesme shqiptare mbi ekzistencën e mjeteve, portave dhe programeve të ndryshme europiane të cilat janë në mbështetje të zhvillimit të biznesit.

5.4. Fushata Promovuese

“E Dua Shqip” është fushata promovuese e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në mbështetje të bizneseve shqiptare dhe produkteve “Made in Albania”. Qëllimi i kësaj fushate është që të njohim, zgjedhim dhe duam çdo ditë produktet shqiptare.

Në kuadër të kësaj fushate AIDA së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë zhvilluan një forum diskutimi mbi Promovimin e Produkteve Lokale, me qëllim hapjen e diskutimeve me përfaqësues të sektorit të tregtisë për promovimin e produkteve shqiptare dhe forcimin e markës “Made in Albania”.

Në vijim të forumit të parë, AIDA së bashku me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë zhvilloi forumin e dytë me temë "Politikat e Aksesit në Financë" dhe rolit që kanë për mbështetjen e sipërmarrjeve shqiptare. Ky forum kishte si qëllim diskutimin me përfaqësues të sektorit privat dhe sektorit financiar për qasje të reja në financë dhe në mbështetje dhe promovim të produkteve shqiptare.

6 KOORDINIMI I AIDA-S

6.1. Hyrje

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Koordinimit është mbajtja dhe koordinimi i marrëdhënieve institucionale me institucione dhe organizma brenda dhe jashtë vendit, duke bashkëpunuar me drejtoritë e tjera të AIDA-s. Gjithashtu, kjo drejtori koordinon edhe raportimet e ndryshme të institucionit si në kuadër të performancës, ashtu edhe të raportimeve që kanë të bëjnë me angazhime në kuadër të marrëveshjeve apo nismave që Shqipëria ka në nivel rajonal apo evropian.

6.2. Map Rea

Gjatë vitit 2020 janë ndjekur dhe është dhënë kontribut për të gjitha çështjet që lidhen me MAP REA (Plani Shumëvjeçar i Zonës Ekonomike Rajonale) dhe më në detaje komponenti i shtyllës së investimeve në kuadër të IRAP (Investment Reform Action Plan). Kontributi përfshin: draftimin e VKM-ve në lidhje me IRAP (miratuar nga Këshilli i Ministrave), zbatimin e masave të parashikuara në Planin e Aksioneve si dhe raportimet përkatëse.

Në këtë kuadër gjatë vitit 2020 janë zhvilluar edhe disa takime si në nivel teknik në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në nivel vendim-marrës në strukturat e Kryeministrit ashtu edhe me donatorët dhe aktorë të tjerë. Më konkretisht:

- 9 qershor dhe 15 korrik – Pjesëmarrje në takim online në lidhje me komponentin e investimeve në kuadër të MAP REA 2.0. Takimi ishte rajonal (WB6) dhe ishte organizuar nga RCC.

- 19 qershor- 30 korrik – Dërgimi i komenteve tek RCC mbi draftin e propozuar të planit të aksioneve.
- 15 korrik - Dërgimi i komenteve para mbledhjes së SHERPA.
- 9 tetor 2020 – Takim për komponentin e investimeve datë 9 tetor 2020.

6.3. Kontribut në kuadër të BE – Shqipëri

Kontribute në kuadër të BE-së. AIDA është kontribuese gjithashtu në kuadër të përafrimit të legjisllacionit me BE-në, kryesisht në Kapitullin 20 "Për politikat industriale". Në këtë kuadër është marrë pjesë në disa takime si dhe janë kryer një sërë raportimesh:

- 23 shkurt – Takim të Sekretariateve Teknike të GMIP (Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave), në KM
- 24 shkurt – Pjesëmarrje në takimin me Sekretariatit Teknik të MFE të GMIP
- 10 qershor – Pjesëmarrje në takimin me Nënkomitetin BE-Shqipëri
- 24 korrik – Pjesëmarrje në takimin me GNPIE për kapitullin 20. Kontribut për PKIE 2021 – 2023, në GNP të kapitullit 20 dhe në GNP të Kriterit Ekonomik.
- LGA dhe IAGA të kapitulli 20 janë në proces rishikimi; është dhënë kontributi si me pjesëmarrjen në takime online ashtu edhe janë plotësuar kërkesat që janë bërë për plotësim informacioni
- Kontribut për raportimim në kuadër të takimit të Nënkomitetit BE – Shqipëri për çështjet ekonomike e financiare.

6.4. Sistemi E-Invest

Përgjatë vitit 2020 është vijuar me mbikëqyrjen e ecurisë së sistemit e-invest dhe funksionimin e përditshëm të sistemit. Janë përmbledhur problematikat që janë hasur në rastet e mosfunksionimit dhe janë realizuar takime me IKUB dhe AKSHI-n, ku janë pasqyruar defektet dhe është diskutuar mbi zgjidhjen e tyre.

Në kuadër të sistemit e-invest janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Dërgimi zyrtar i ToR-s në lidhje me Modulin AfterCare tek AKSHI.
- Realizimi i trajnimit për e-invest me networkun e pikave të kontaktit dhe punonjës të rinj të AIDA-s (account managers).
- Testimi në sistem i të gjitha ndryshimeve që janë bërë pas takimeve ku në linja të përgjithshme u konstatua se ndryshimet janë të vogla, ndërsa problematika shfaq pamundësi e përdoruesve për të hapur dhe azhornuar lead që menaxhojnë, duke sjellë si pasojë nxjerrjen e raporteve të pasakta.
- Prodhimi i raporteve të para nga sistemi (edhe në formë grafiqesh dhe tabelash), ndonëse akoma të saktë për shkaqet e përmendura më lart, por që shërbejnë si bazë për të parë llojet e raporteve që mund të prodhohen.
- Me kërkesë të grupit të Harvard janë prodhuar dhe dërguar tabela në lidhje me FDI, duke respektuar dhe ruajtur konfidencialitetin e investitorëve.
- Me pasqyrimin e ndryshimeve të fundit, vërehet që leads që nuk hapeshin, tanimë hapen dhe janë funksionale.
- Janë testuar ndryshimet dhe propozimi për planin e veprimit në sistem dhe i janë dërguar IKUB dhe AKSHI-t.
- Është zhvilluar një mbledhje me MEPJ në lidhje me funksionimin e sistemit, ku dolën edhe problematika rast pas rasti të cilat iu dërguan IKUB dhe AKSHI.
- Është testuar moduli i planit të veprimit i propozuar nga IKUB dhe janë dërguar propozimet respektive.
- Është testuar propozimi mbi zgjidhjen e modulit AfterCare.
- Është në proces asistimi i MEPJ për raportet e ndryshme, ashtu edhe për problematika që kanë ambasadorët me leads.

6.5. Strategjia e Migracionit

Në kuadër të Strategjisë së Migracionit dhe Planit të Veprimit 2019 - 2022, AIDA është institucion leader në një pikë të planit të miratuar me VKM-në 400, datë 19.06.2019.

Në kuadër të strategjisë së migracionit janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Ngritja e një grupi pune me pjesëmarrjen e institucioneve që janë ndihmesë në këtë proces, nga ku është vijuar me dërgimin dhe marrjen e të gjithë emrave, pjesë e grupit të punës, në kuadër të planit të veprimit.
- I janë kërkuar IOM formularët e përdorur në anketën e bërë në Itali me qëllim përgatitjen e formularit përkatës së anketimit. Me përcjelljen e informacioneve nga ana e IOM dhe bazuar në inputet e Drejtorisë së FDI, AIDA ka realizuar draftin përfundimtar, të cilin e ka shpërndarë tek anëtarët e grupit të punës për sugjerime.
- Është draftuar pyetësori i cili në vijim i ka kaluar anëtarëve të grupit të punës për mendim.
- I janë kërkuar Ministrit të Shtetit për Diasporën dhe MEPJ listat e bizneseve të diasporës me qëllim targetimin e shteteve dhe bizneseve.
- Pas qarkullimit të pyetësorit në të gjitha institucionet e përfshira në grupin e punës, është hartuar versioni përfundimtar.
- Janë marrë listat e anëtarëve të diasporës nga MEPJ dhe Ministri i Shtetit për Diasporën dhe është krijuar një listë e përbashkët, ku janë filtruar bizneset që u dërgohet pyetësori.
- Për shkak të numrit të vogël të bizneseve në listë, pyetësori është vendosur të mos të ketë targetim shteti, por të dërgohet i njëjtë në të gjithë shtetet ku ka biznese të diasporës;
- Janë kryer takime me Qendrën e Biznesit të Diasporës në lidhje me zgjerimin e listës së bizneseve për t'u anketuar.
- Është përfunduar pyetësori dhe i është dërguar INSTAT për hedhjen në google forms, ndërkohë, që janë bërë teste me personelin e AIDA-s dhe i janë dërguar ndryshimet e nevojshme INSTAT-it.
- Është përfunduar pyetësori me të gjitha ndryshimet. INSTAT ka kryer hedhjen në google forms. Është testuar pyetësori para se t'i dërgohet bizneseve të diasporës.

7 AIDA NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT NDËRINSTITUCIONAL

7.1. Programi i transparencës

Si një institucion publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë, dhe që drejtohet nga bordi drejtues, AIDA funksionon në përputhje me standardin e transparencës duke siguruar gjatë veprimtarisë së saj zbatimin rigoroz të detyrimeve që rrjedhin prej Ligjeve 119/2014 "Për të drejtën e informimit" dhe 9887/2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", të ndryshuar, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tyre.

Përgjatë vitit 2020, në zbatim të nenit 5 të Ligjit nr. 119/2014, AIDA ka kryer rishikimin e Programit të Transparencës të miratuar, duke e përditësuar me ndryshimet e nevojshme.

Në procedurën e rishikimit janë vlerësuar edhe ndryshimet në strukturën dhe organikën e institucionit, të cilat diktuan një ndarje të re të detyrave dhe përgjegjësi të secilës njësi organizative për konceptimin dhe zbatimin e programit të transparencës, duke vlerësuar praktikën e mira ndërkombëtare të miratuara në Autoritete Publike të njëjta, si dhe duke synuar në tërësi përmirësimin e tij.

Në përgatitjen e rishikimit të programit të transparencës është mbajtur parasysh interesi më i lartë i publikut, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesat individuale për informacion dhe sidomos:

- Garantimin e njohjes maksimale me informacion për të gjitha fushat e veprimtarisë së institucionit;
- Vënien në dispozicion, pa kërkesë, të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
- Modelet e miratuara për kategoritë e institucioneve publike nga Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Gjatë vitit raportues, në veprimtarinë e AIDA-s ka qenë thelbësore rritja e transparencës dhe

llogaridhënies, në veçanti duke siguruar funksionimin efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik, menaxhimit të financave publike, legjislacionit, mekanizmave monitorues, strukturës organizative të AIDA-s, deklarimet e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 119/2014 dhe qasjes proaktive për informacione që promovojnë interesin publik të përcaktuar në drejtim të dhënies së informacionit, AIDA ka vendosur në shërbim të publikut dhe palëve të tjera të interesuara, informacione dhe të dhëna konkrete në lidhje me investimet e huaja direkte dhe investime strategjike, duke përfshirë kriteret e përzgjedhjes dhe sektorët e nënsektorët strategjikë, sikurse edhe masat mbështetëse dhe procedurat e aplikimit.

Për të siguruar një transparencë sa më efektive, AIDA ka vënë në dispozicion të publikut manualin udhëzues mbi legjislacionin e investimeve strategjike, por edhe rregulloren e Komitetit të Investimeve Strategjike dhe Vendimet e tij.

Duke qenë se për qëllim të përmirësimit të klimës së investimeve dhe mjedisit të biznesit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt një qasje të re politike në zbatimin e paketave ligjore specifike preferenciale, duke krijuar Zona të reja Teknike dhe Ekonomike të Zhvillimit (TEDA), të përcaktuara posaçërisht për zhvillimin e parqeve industriale që do të përfitojnë nga legjislacioni i veçantë dhe stimujt për investime, AIDA gjithashtu i ka mundësuar publikut një akses të veçantë në informacionet dhe të dhënat kryesore lidhur me këto hapa. Në mënyrë specifike, publiku ka mundësinë të marrë një informacion të shpejtë dhe pa kosto të lejeve të lidhura me veprimtaritë e investimeve strategjike në këto zona, sipas legjislacionit të investimeve strategjike.

Gjithashtu, sipas orientimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e

të Dhënave Personale, AIDA, në përmbushje të detyrimeve ligjore, me qëllim përcaktimin e procedurave organizative e teknike, masave për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sigurisë, ruajtjes dhe administrimit të të dhënave personale, ka miratuar me urdhrin nr. 176 prot., datë 23.12.2019, të Drejtorit Ekzekutiv të AIDA-s, Rregulloren "Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA)".

Miratimi i kësaj rregulloreje është bërë me qëllim mbrojtjen e çdo informacioni në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.

Së fundmi, AIDA, në faqen zyrtare të internetit ka publikuar edhe dokumentin "Politika e privatësisë", me anë të të cilit njofton të gjithë përdoruesit e faqes mbi ruajtjen e privatësisë së tyre, duke u treguar se çfarë duhet të presin kur AIDA mbledh të dhënat e tyre personale.

Në shërbim të publikut dhe përmirësimit të procedurave administrative, pjesë e transparencës janë dhe formularët elektronikë për kërkesa/ankesa, duke mundësuar thjeshtimin e procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut. Në çdo rast, për çdo pyetje dhe informacion të mëtejshëm, në kuadër të programit të transparencës publikut i janë vënë në dispozicion edhe të dhënat e kontaktit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale pranë AIDA-s.

7.2. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Duke konsideruar menaxhimin e burimeve njerëzore si një prej elementëve thelbësor për krijimin e një administrate profesionale, të qëndrueshme, efektive dhe të përgjegjshme, AIDA ka synuar përmirësimin dhe përafrimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe administrative me standardet dhe praktikën me të mira në vend. Ndryshimet në strukturën dhe organikën e AIDA-s, të shoqëruara me ndryshimin e legjislacionit zbatues për rregullimin e marrëdhënieve të punës së punonjësve të in-

stitucionit, diktuan një qasje të re të AIDA-s në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjëseve të veta ligjore.

Për këtë arsye, u miratuan edhe kërkesat specifike të pozicioneve të punës së AIDA-s, me qëllim ndarjen sa më efektive të detyrave dhe funksioneve të pozicioneve të reja të punës, duke synuar pasjen dhe rekrutimin e punonjësve, të cilët të mund të përballojnë sfidat dhe proceset që diktohen nga ndjekja e aktiviteteve kryesore të secilit pozicion pune.

AIDA, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse ka organizuar dhe drejtuar punën për zbatimin me përpikëri të legjislacionit të punës, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit, zhvillimit të karrierës, si dhe përmirësimit të sistemit të trajnimit të stafit.

Drejtoria ka ndjekur me rigorizitet zbatimin e Vendimit nr. 1, datë 25.03.2019 të Bordit Drejtues të AIDA-s, me të cilin është vendosur që "Marrëdhëniet e punës për punonjësit e AIDA-s të rregullohen me Kod Pune", duke zbatuar të gjitha përcaktimet ligjore për daljen e punonjësve nga shërbimi civil dhe rregullimin e marrëdhënies së tyre të punës sipas dispozitave të kodit të punës.

Drejtoria e Shërbimeve mbështetëse është angazhuar dhe ka ndjekur në vijimësi procedurat e rekrutimit të punonjësve për vendet vakante, me qëllim realizimin e këtij procesi duke ju përmbajtur përcaktimve ligjore, kritereve dhe specifikeve për secilin pozicion vakant, në zbatim të ligjit nr. Ligjin 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Për punonjësit janë ndjekur procedurat e lëvizjes paralele (1); lirime nga detyra (3) si dhe emërimet të përhershme e të përkohshme në detyrë kundrejt kontratave të lidhura me personat e emëruar.

Janë plotësuar vendet vakante të punës me 6 emërimet të reja për vitin 2020, konkretisht:

- 2 specialist, 1 sanitar, 1 arkiv-protokoll, dhe 1 Drejtor Drejtorie.
- Vende vakant për institucionin janë aktualisht 4 pozicione:
2 Drejtor Drejtorie,
2 specialist.

7.2.2. Zhvillimi i burimeve njerëzore

Në kuadër të zhvillimit dhe ngritjes së aftësive profesionale të kapaciteteve njerëzore e në vijim të strategjisë së trajnimeve për vitin 2020, janë realizuar:

- Trajnime me tema të përgjithshme për ngritjen e aftësive prezantuese, të punuarit në grup, të cilat janë organizuar edhe në ambientet e AIDA-s, me ekspertë të huaj.
- Përgatitja e vlerësimit vjetor për punonjësit, dhe vlerësimi nga eprorët direkt, mbi arritjet e rezultateve në punë si dhe mbi evidentimin në bazë të vlerësimit të nevojave për trajnim të stafit.
- Në bazë të Rregullores të nxjerrë nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë është bërë raportimi ditor (gjatë gjithë periudhës së pandemisë), po në këtë ministri, i numrit të punonjësve që punojnë nga zyra dhe punonjësve që punojnë online, si rrjedhojë e masave të marra për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19.
- Përditësimi i dosjeve të punonjësve në sistemin e HRMIS, hedhja e të dhënave të përditësuar për punonjësit ekzistues dhe të rinj, plotësimi më dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit.

7.2.3. Rritja e kapaciteteve të punonjësve

Kryerja e trajnimeve mbi rritjen e kapaciteteve individuale të punonjësve për vitin 2020 me temat përkatëse për zhvillimin dhe bashkëpunimin me programe të mbështetjes së SME-ve shqiptare si dhe mbi politikat e Investimeve të Huaja direkte si vijon:

- Workshop nga SIPPO Albania -5 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) në bashkëpunim me Programin e Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar (AASF) dhe RISI Albania- 3 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga Këshilli Kinez për Promovimin e Tregtisë Ndërkombëtare me teme "2020 Webinar on Trade and Investment Promotion Cooperation and Exchange of Chambers of Commerce and Industry of CEE countries" -3 punonjës pjesëmarrës

- Trajnim nga EBRD - 5 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga Turkish Cooperation and Coordination Agency- me teme: "Programi i Shkëmbimit të Eksperiencës" -7 punonjës pjesëmarrës
- Webinar me temë: "Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar" - (AASF) në bashkëpunim me programin e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) -4 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim mbi Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB) dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptar, mbi mundësitë që Fondi i Garancisë dhe skemat e IPARD në drejtim të rritjes së investimeve në fushën e Agrobiznesit shqiptar - 3 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga WB6 IPP Team, mbi qasjen e promovimit të investimeve gjatë periudhës së pandemisë -7 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga GIZ, mbi sektorin e AfterCare - 7 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga ASPA, në kuadër të Prokurimit Publik - (1 punonjës pjesëmarrës)
- Trajnim nga Ambasada Italiane në Shqipëri – me temë: "Mundësitë e reja të investimit në Shqipëri: kriptovalutat, Blockchain dhe tregjet financiare sipas ligjit të ri Fintoken Act" -2 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga World FZO me temë: "Safe Zone Global Launch" -2 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim me temë: "Introduction to Sustainability-Driven Innovation Management and Tools" organizuar nga European Innovation Management Academy, -4 punonjës pjesëmarrës
- Webinar mbi fokusin në ekonomi organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë -4 punonjës pjesëmarrës
- Trajnim nga GIZ mbi kapitujt e procesit të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Europian - 3 punonjës pjesëmarrës

7.2.4. Specifikat e punës në kushtet e COVID-19

Bazuar në kërkesën e Komisionit të Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, u ngrit grupi i punës dhe u hartua Plani i Masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, si dhe u bë përshtatja e këtyre masave në rregulloren e institucionit.

Pas përgatitjes së Plan Masave, u hartua Urdhri i Miratimit si dhe u bë përcjellja e tyre për dijeni të punonjësve të Agjencisë. Plan i masave i'u dërgua Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19 ishte e nevojshme të bëhej një orientim tjetër i shpenzimeve të parashikuara në buxhet për vitin 2020. U realizua rishikimi i parashikimeve buxhetore për shpenzimet korrente, me qëllim orientimin e këtyre shpenzimeve në përmbushjen e objektivave të tjera të ndryshme nga ato të parashikuara fillimisht.

Hartimi dhe përcjellja e nevojave drejtuar Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara mbi prokurimin e produkteve mbrojtës ndaj Covid -19 sipas specifikimeve teknike të unifikuara. Gjithashtu, në zbatim të urdhërit nr 80, datë 17.11.2020 "Për Miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara gjatë periudhës së epidemisë të shkaktuar nga COVID-19 dhe periudhës së zgjatjes së vitit shkollor 2020-2021", u morën masa për zbatimin e këtij vendimi dhe u hartuan grafikët për secilën drejtori, duke alternuar punën në zyrë me atë në kushtet e shtëpisë.

7.3. Treguesit financiarë

7.3.1. Menaxhimi i burimeve financiare

Hartimi dhe detajimi i buxhetit është bërë në përputhje me Ligjin nr. 88, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020", Ligjin nr. 9936, datë 26.08.2008 "Për sistemin e menaxhimit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si edhe me Ligjin 10303, datë 15.07.2010 "Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve AIDA, në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit është mbështetur në nevojat më të domosdoshme institucionale në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga ligjet organike mbi të cilat ushtron veprimtarinë e tij. Gjithashtu, ka krijuar dhe monitoruar një sistem të menaxhimit financiar dhe kontrollit, i cili është mbështetur në legjislacionin në fuqi konformë dispozitave të Ligjit nr. 10296, datë 8/07/2010 "Mbi menaxhimin financiar e kontrollin", si dhe mbi parimet e menaxhimit të fondeve publike me efektivitet, transparencë, ekonomi dhe efikasësi.

Për të realizuar një menaxhim financiar efikas për vitin 2020, janë ndërmarrë hapa konkret në përshtatje me ndryshimin e kushteve si rrjedhojë e pandemisë Covid-19. Më konkretisht:

- Detajimi i shpenzimeve buxhetore korrente dhe kapitale për vitin 2020 mbi bazën e fondeve të alokuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në artikujt për paga, sigurime shoqërore, shpenzime për mallra e shërbime, transferime në buxhete familjare si dhe investime, sipas projekteve të miratuara në nivel mujor e vjetor.
- Rishikimi i planeve të detajuara në muaj për shpenzimet operative dhe investime për vitin 2020 si dhe rishpërndarja e tyre në muajt pasardhës në zbatim të udhëzimit të përherëshëm "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit" si dhe duke respektuar përqindjet e vendosura nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë;
- Përgatitja, rakordimi i llogarive vjetore si dhe plotësimi i pasqyrave financiare me anekset përkatëse mbi gjendjen e aseteve fikse e qarulluese dhe gjendjen financiare në fund të vitit 2020, në zbatim të ligjeve dhe udhëzimeve në fuqi, brenda afateve kohore të përcaktuara në to.
- Planifikimi, përgatitja dhe dërgimi pranë Ministrisë së Financave të kërkesave buxhetore të detajuara, të Projektbuxhetit Afatmesëm 2021-2023, në zbatim të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2021-2023", si dhe të udhëzimit "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit Buxhetor Afatmese", me anekset e tyre përkatëse, gjatë të dy fazave, prill dhe gusht 2020. Sipas udhëzimeve për hartimin e PBA 2021-2023, hapave dhe procedurave të miratuara në to janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të AIDA-s, për realizimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme, mbi baza produkteve.
- Hartimi dhe dërgimi i Raportit Vjetor për vlerësimin e sistemit ekzistues, menaxhimit financiar si dhe cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 8/07/2010 "Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Përcaktimi i personave përgjegjës të cilët kanë përgjegjësinë mbi menaxhimin me efikasësi

ekonomi dhe efektivitet të burimeve financiare dhe jofinanciare në mbështetje të arritjes së objektivave, politikës dhe qëllimeve të institucionit në zbatim të ligjit të mësipërm.

- Përcjellj informacionin pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë mbi pakësimet e fondeve në kuadër të shpalljes së gjendjes së emergjencës.
- Hartimi i "Strategjisë së Menaxhimit të Risikut" duke zbatuar legjislacionin në fuqi.


7.3.2. Zbatimi i Buxhetit

Bazuar në paketën ligjore të miratuar në kuadër të përballimit dhe kapërcimit të situatës së shkaktuar nga Covid-19, lidhur me ndryshimet në Buxhetin e Shtetit 2020, u reduktuan fondet nga buxheti i AIDA-s dhe i kaluan Aparatit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Hartimi dhe detajimi i buxhetit për shpenzimet në funksion të përmbushjes së objektivave të AIDA-s.

DA-s. Ky buxhet është detajuar në fillim të vitit dhe më tej është rishikuar gjatë vitit për shkak të ndryshimit të kushteve që lidhen me pandeminë e shkaktuar nga Covid-19 dhe realizimit të procedurave të marrjes me qira të ambienteve të reja të punës.

Gjatë vitit 2020, me ndryshimet e bëra në buxhetin e vitit 2020 në përshtatje të kushteve të reja, u realizuan shpenzimet korrente dhe kapitale siç paraqiten në grafikun e mëposhtëm. Parashikimi në fillim të vitit për paga dhe sigurime u realizua përkatësisht në masën 97% dhe 96%. Për sa i përket shpenzimeve korrente, ato u realizuan në masën 77%. Ky realizim jo i plotë i këtyre shpenzimeve vjen si rrjedhojë e pandemisë Covid-19, për shkak të së cilës u pezulluan aktivitetet e planifikuara. Shpenzimet për transferta individësh u realizuan në masën 3% dhe shpenzimet për TVSH që lidhen me projektin EEN u realizuan në masën 2%.



- Janë përmbyllur dhe rakorduar me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit për Pasqyrën Financiare të vitit 2020, të gjitha pasqyrat financiare sipas formateve të kërkuara dhe janë realizuar gjatë vitit rakordimet me thesarin për të gjitha shpenzimet e realizuara sipas muajve.
- Realizimi i hartimit të PBA-së 2021-2023 në përputhje me nevojat e Institucionit sipas hapave dhe procedurave të miratuara në to

- janë planifikuar nevojat për mbështetje financiare, në funksion të përmbushjes së misionit të AIDA-s, për realizimin e objektivave afatshkurtra e afatmesme, mbi baza produktesh. Ky proces është realizuar sipas legjislacionit në fuqi në dy fazat e tij, gjatë muajit prill 2020 dhe gusht 2020.
- Plotësimi i nevojave Institucionale të shërbimeve dhe mallrave, nëpërmjet realizimit të procedurave të prokurimit publik,

duke plotësuar nevojat e përgjithshme, por gjithashtu duke plotësuar nevojat për mbrojtjen nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19.

- Hartimi i pyetësorit të vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit (MFK).
- Hartimi i "Strategjisë së Menaxhimit të Riskut" duke realizuar identifikimin, vlerësimin e riskut dhe adresimit të tij dhe regjistrin e riskut.

- Ruajtja dhe administrimi i aseteve (pasurisë) së AIDA-s, duke vlerësuar dhe zhvlerësuar sipas rregullave ligjore, Ligji nr. 10296, dt. 08.07.2010 "Per menaxhimin financiar dhe kontrollin".
- Kryerja e regjistrimeve kontabël si edhe rakordimi i gjendjes kontabël me atë fizike të llogarive në ditarin e shpenzimeve dhe kartelat analitike.

8 SHQIPËRIA NË EXPO 2020 DUBAI

EXPO 2020 DUBAI është një panair botëror, i cili do të mbahet në Dubai, Emiratet e Bashkuara Arabe, përgjatë periudhës 1 tetor 2021 deri në 31 mars 2022. Shqipëria do të jetë pjesëmarrëse në panairin botëror EXPO 2020 DUBAI.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) në rolin e institucionit koordinues, e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv z. Sokol Nano, në rolin e Komisarit të Përgjithshëm të Shqipërisë, do të menaxhojë dhe administrojë pavijonin shqiptar në panairin ndërkombëtar EXPO 2020 DUBAI.

Panairi do të mirëpresë 190 shtete pjesëmarrëse, si edhe miliona vizitorë nga e gjithë bota me synimin dhe qëllimin e nxitjes e krijimit të partneriteteve ndërkombëtare, shkëmbimit të kulturave, mundësive të biznesit dhe investimeve.

Pjesëmarrja e vendit tonë në këtë panair, do të shërbejë si një mundësi e rëndësishme për promovimin e Shqipërisë si një destinacion i veçantë dhe i qëndrueshëm turistik, duke shpalosur bukuritë e vendit tonë, kulturën dhe traditën e pasur shqiptare.

Një nga objektivat kryesorë do të jetë promovimi i Shqipërisë si një partner i besuar tregtar dhe i investimeve të huaja në një sërë sektorësh të rëndësishëm për vendin si energjia, turizmi, infrastruktura, bujqësia, etj.

Pavijoni i Shqipërisë në EXPO 2020 DUBAI do të jetë simbol i identitetit kombëtar, duke pasqyruar një Shqipëri me ngjyra, të re dhe dinamike, e

cila ofron një destinacion mjaft tërheqës turizmi dhe në të njëjtën kohë një destinacion për investime të huaja, duke evidentuar avantazhet dhe potencialet që Shqipëria mbart, si dhe duke reflektuar filozofinë dhe prioritetet e EXPO 2020 DUBAI. Titulli i pavijonit do të jetë "Albania a Timeless Trip". Ngjyrat kryesore të pavijonit janë: e zezë, e kuqe dhe gri.

Nëntemat kryesore të EXPO 2020 DUBAI do të jenë: Mundësi (Opportunity), Lëvizshmëri (Mobility) dhe Qëndrueshmëri (Sustainability) duke shërbyer si platforma që nxitin kreativitetin, inovacionin dhe bashkëpunimin global. Pavijoni ynë bën pjesë në nëntëmën Lëvizshmëri - (Mobility) nën moton: "Albania, a timeless trip".

"Albania, a timeless trip" do të jetë një pavijon për të eksploruar trashëgiminë kulturore, historinë dhe peizazhet e Shqipërisë, të cilat luajnë një rol në formësimin e karakterit të saj dinamik dhe një ftesë për të vlerësuar dhe investuar në infrastrukturën e vendit dhe sektorin e energjisë së rinovueshme.

Në fasadën e pavijonit janë vendosur një seri imazhesh, ku 2 prej të cilave shfaqin natyrën shqiptare, ndërsa pjesa tjetër portrete njerëzish që përcjellin dinamikën e brezave, gjinive, kulturave dhe tiparet e popullit tonë.

Hapësira e brendshme e pavijonit ndahet në:

- Zona e hyrjes
- Zona kryesore e ekspozitës
- Zona për ekspozime të veçanta
- Zona për fëmijë
- Zona e shitjeve

Objektet dhe elementet që do të ekspozohen brenda pavijonit janë fije simbolike të strukturës së historisë dhe identitetit tonë kombëtar. Është planifikuar një listë sendesh siç janë: 5 kostume tradicional autentik; makete të 2 kalave, Berat edhe Gjirokastrë; maketi i Parkut Kombëtar të Lurës; lahuta dhe cyla dyjare; maketi i anijes së flotës Liburnia; një pemë ulliri; piktura me motive të tekstilit shqiptar; maketi i piramidës sipas projektit të rijetësimit dhe dy sete me korniza, njëri me bimë të thara dhe tjetri me gurë mineral nga të gjitha krahinat e Shqipërisë. Për të kompletuar pamjen e pavijonit në brendësi janë përzgjedhur imazhe të siteve Shqiptare në UNESCO, zona turistike bregdetare, malore etj., të cilat do të shfaqen në panele LED pranë objekteve të ekspozuara.

Zona e shitjeve do të ofrojë produkte shqiptare si mjalti, vaji i ullirit, bimë aromatike, punime artizanale druri, maskat e mirënjohura veneciane të prodhuara në Shkodër si dhe aksesore të prodhuar në teknologjinë inovative 3D. Ndërsa zona e fëmijëve është konceptuar si një atelie, në të cilën do të vendosen 2 telajo dhe mjetet e nevojshme për të pikturuar. Në këtë zonë gjithashtu do të ketë libra me përralla dhe është planifikuar të shfaqet një kolazh i filmave të vjetër vizatimorë shqiptarë.

Me këtë koncept kemi krijuar një pavijon që manifeston energjinë e vendit dhe e portretizon atë në një dritë të gjallë dhe bashkëkohore në sytë e vizitorëve.

Aktivitetet e Shqipërisë në Expo 2020 Dubai

AIDA, nëpërmjet mbledhjeve të grupit të punës, ka mbledhur dhe hartuar një kalendar paraprak

të aktiviteteve të propozuara nga grupi i punës, të cilat do të zhvillohen përgjatë 6 muajve të Expo 2020 Dubai. Këto aktivitete do të mbulojnë prezantimin e sektorëve si bujqësia, energjia e rinovueshme, inovacioni, edukimi, etj. dhe nxitjen e investimeve të huaja në Shqipëri.

Dita Kombëtare

Secili nga shtetet pjesëmarrëse në EXPO 2020 ka një ditë të dedikuar që e vendos atë shtet në qendër të vëmendjes të asaj dite. Dita kombëtare e Shqipërisë është në datën 9 mars 2022. Ceremonia zyrtare e ditës kombëtare përfshin delegacionin nga Shqipëria dhe atë të Emiratëve të Bashkuara, të cilët do të ndjekin një protokoll të veçantë për takimet, vizitat dhe eventet që do të mbahen gjatë kësaj dite.

AIDA ka nisur organizimin e aktiviteteve të ditës kombëtare, të cilat do të kenë karakter më së shumti artistik, por edhe aktivitete me fokus zhvillimin e biznesit dhe investimeve strategjike në vend.

Gjithashtu, në këtë ditë do të mbahet një shfaqje kulinarie ku do të gatohen 3 pjata tradicionale shqiptare: qifqi, fërgesë me specat dhe hallvë me akullore e rrush të thatë.

Përralla Shqiptare në Expo 2020

Shqipëria është tashmë pjesë e 2 botimeve të para në "Libri për Fëmijë Expo 2020", i cili është një libër me përralla ndërkombëtare nga çdo shtet pjesëmarrës në Expo. AIDA ka siguruar përshtatjen e përrallës "E bija e hënës dhe e diellit" në gjuhën angleze dhe ilustrimet shoqëruese të kësaj përralle.

PROJEKTE KONKRETE TË TRAJTUARA ME LIGJIN E INVESTIMEVE STRATEGJIKE

Nr	Subjekti Aplikues/ Emri i Projektit	Sektori	Vlera/Punë simi	Afati i realizimit	Përshkrimi	Vendnd dhja	Pronësia	Procedura	Status Aktual
PROJEKTE TË MIRATUARA									
1	MANE TCI "New Born"	Turizëm	€ 26,000,000 250 vende pune	13.03.202 0	Kompleks turistik në S=187,000 m2.	Hamallaj , Durrës	Privat	Procedure Asistuar me VKIS Nr. 1/15 datë 14.7.2016	Është realizuar afërsisht 95% e investimit.
2	GREEN COAST "Green Coast 1"	Turizëm	€ 52,500,000 250 vende pune	27.04.202 1	Kompleks turistik në S=183,500 m2.	Palasë, Himarë	Privat	Procedure e Veçante me VKIS Nr. 2/13 datë 14.7.2016	Është realizuar mbi 50% e investimit.
3	ALB PANEL NGR "Albpanel"	Bujqësi Industriale	€ 15,000,000 300 vende pune	38 muaj nga data e fillimit pasi investimi nuk ka filluar ende	Projekti synon te përdorë lende te pare kallamin dhe te prodhojë si produkt final panelet MDE.	Libofshe, Fier dhe Rremas, Lushnje	Shtet	Procedurë e Asistuar me Vendim te KIS Nr. 7/1, datë 5.12.2016	Janar 2020, KIS miratoi një ndryshim në vendimin për Albpanel për ndryshim zone. Vendim KIS NR. 7/5 , datë 7.1.2020.
4	AGROCON ALBANIA "Agrocon"	Bujqësi	€ 5,832,000 120 vende pune	26.01.201 9	Ferme Bujqësore në S=30 Ha.	Ngurrëz e Vogël, Krutje, Lushnje	Shtet	Procedurë e Asistuar me Vendim te KIS Nr. 21/2, datë 20.12.2017	Është realizuar afërsisht 95% e investimit.
5	CONCORD INVESTME NT "Gone Perivol"	Turizëm	€ 32,500,000 200 vende pune	12.04.202 2	Kompleks Turistik	Palasë, Himarë	Privat	Procedurë e Asistuar miratuar me Vendim te KIS nr. 24/2, date 20.11.2017.	Është realizuar afërsisht 20% e investimit.
6	CONCORD INVESTME NT "San Pietro"	Turizëm	€ 88,000,000 250 vende pune	05.05.202 0	Kompleks Turistik	Gjiri i Lalzit	Privat	Procedurë e Veçantë miratuar me vendim te KIS Nr.25/2, date 20.12.2017	Është realizuar afërsisht 60% e investimit. Me vendim të KIS dhjetor 2020, është bërë shtyrja e afatit të Statusit për një periudhë 2 vjeçare.
7	BOIKEN SHPK "Kepi Merli"	Turizëm	€ 78,000,000 263 vende pune		Eko Resort	Ksamil, Sarandë	Shtet (Subjekti person i stimulua r)	Subjekti aplikoi për Procedurë e Veçantë. Me vendim et KIS nr. 27/2, datë 20.12.2017, u vendos një afat 30 dite	Projekti në proces zbatimi

								pune shprese për shqyrtim të mëtejshëm nga MTM. Miratuar me VKIS nr. 27/5 date 04.03.2019	
8	XH&M CO "Delta Bay"	Turizëm	€ 22,700,000 107 vende pune		Kompleks Turistik	Palasë, Vlorë	Privat	Subjekti ka aplikuar për Procedurë e Asistuar. Me vendim të KIS Nr. 23/2, date 20.11.2017 u vendos që duhet pritur vendimi i KKT.	Subjekti nuk ri ka aplikuar tek AIDA
9	STAR TEK "Dhërmi"	Turizëm	€ 12,140,000 300 vende pune		Resort Turistik	Dhërmi	Shtet	Subjekti aplikoi për Procedurë të Asistuar. Me Vendim të KIS nr. 28/2, datë 20.12.2017 u dha një afat shtesë prej 30 ditë pune për të plotësuar projektin me dokumentacion shtesë nga ana e subjektit Miratuar VKIS nr. 2/3 datë 02.09.2019	Projekti fillon zbatimin pasi të bëhet regjistrimi fillestar i zonës
10	GPP KORÇA	Energji (TEC Korça)	€ 349,700,000 123 vende pune	3 vite nga data e fillimit të investimit.	HEC Korça	Korçë	Shtet	Procedurë e veçantë miratuar me vendim të KIS Nr.30/4, date 14.02.2018	Subjektit i është refuzuar Deklarata Mjedisore nga MTM.
11	EUROCOL White Rocks	Turizëm	€ 6,800,000 81 vende pune	3 vite nga fillimi	Resort Turistik	Dhërmi, sip. 1.91 Ha	Privat	Procedurë e asistuar, miratuar me VKIS nr.15/3, date 04.03.2019.	Projekti në proces zbatimi

12	AQUATIO Akuaponi – hidroponi	Bujqësi	€ 5,1 mln 50 vende pune	6 muaj nga data e fillimit te investimit	Akuaponi – hidroponi	Karavasta , Divjake 1,3 ha	Shtet	Procedure e asistuar Miratuar me Vendim KIS nr.4/4, date 19.04.2018	Subjekti ka riaplikuar për një sipërfaqe më të madhe, në të njëjtën zonë ku është miratuar edhe ndryshimi potencial për Albpanel
13	AGROILIRIA Planatacion shegë, avokado, finger lime	Bujqësi	€ 6,627 mln 115 vende pune	5 vite nga data e fillimit. Investimi ka filluar vetëm në 87 ha toke.	Planatacion shegë, avokado, finger lime	Karavasta , Divjake 500 ha	Shtet	Procedurë e asistuar Miratuar me vendim KIS nr. nr.6/4, date 19.04.2018	Në proces nënshkrimi i MGF ndërmjet MFE dhe subjektit. Ndryshim Vendimi me VKIS Nr. 6/9, datë 24.06.2020, me të cilin u miratua zëvendësimi i kulturave me kivi, rrush, dardhë etj,, si dhe zhvillimi i agroturizimit, në zonën e Karavastës, Bashkia Divjakë.
14	YURA COOPERATION ALBANIA	Industri Automotiv e (Zonë me përparësi zhvillimi)	€ 6.459.000	2 vite	Fabrike për prodhimin e pjesëve automotive	Bazo e Tubove Fier	Shtet	Procedure e asistuar Miratuar me VKIS nr 14/3 date 12.02.2019	Projekti ne proces zbatimi
15	SOLEIL & SEA Jala Entertainment Park	Turizëm (Kompleks Turistik)	€ 67,000,000 620 vende pune	3 vite	Resort Turistik	Jale – Vuno, Himarë	Privat dhe Shtet	Miratuar me VKIS Nr. 20/5, date 01/08/2019	Projekti në proces zbatimi. Është pezulluar një pjesë e projektit për shkak të çështjeve të pronësisë.
16	BASHKIA TIRANË “TEDA Kashar”	Zonë e Teknologjisë dhe ZhvillimitE ekonomik	€ 102,666,431	Brenda 1 viti nga vendimi KIS Bashkia duhet të aplikojë për marrjen e statusit final strategjik	Realizimi i një Zone të Teknologjisë dhe Zhvillimit Ekonomik me qëllim tërheqjen e investimeve të huaja dhe teknologjive të reja dhe teknologjive të informacionit, hapjen e vendeve të reja të punës, nxitjen e zhvillimit ekonomik të qytetit të Tiranës duke futur industri që përmbushin standarde ndërkombëtare me produktivitet të lartë.	Në zonën Yzberisht , Gropaj dhe Kashar, Tiranë	Privat dhe Shtet	Miratuar me VKIS Nr. 1/4, darë 04.05.2020	Projekti në proces zbatimi.

17	LAJTHIZA INVEST SH.A "Kompleks Turizëm Rural Lajthiza	Turizëm	€ 20,000,000 200 persona	Dhjetor 2022	Hotel modern, si dhe një fabrikë të re të ambalazhimit të ujit të pijshëm në shishe.	Fshati Lajthizë, Bashkia Fushë – Arrëz	Shtet	Miratur me VKIS Nr. 36/6, datë 24.06.2020	Projekti është në proces.
18	SHIDDI GROUP SH.P.K DHE AL SHIDDI TRADING COMPANY LTD "TIRANA CITY CENTER"	Turizëm	106,850,000 1500 persona	Brenda 6 viteve	Ndërtimi i një investimi kompleks dhe i përket pjesërisht sektorit strategjik të turizmit me strukturë akomoduese elitare turistike-hotel, apartamente elitare hotel, vila elitare Sky Village, strukturë mbështetëse turistike-qendër tregtare dhe garazh nëntokësor ashtu si dhe ndërtesë për zyra.	Tiranë	Shtet	Miratur me VKIS Nr. 2/7, datë 27/07/2020	Duke u vlerësuar përmbushja nga subjekti investues i kriterit financiar duke dëshmuar disponimin e kapacitetit financiar në vlerën prej 20% të vlerës totale të investimit si dhe plotësimin e kushteve paraprake.
19	GREEN COAST SHPK Green Coast	Turizëm	€ 125,400,000 800 vende pune	36 muaj	Ndërtimi i 2 (dy) strukturave akomoduese turistike, hotel 5 yje, si dhe kompleks turistik.	Palasë, Himarë	Privat dhe shtet	VKIS dhjetor 2020	Projekt ka përfituar status strategjik me Vendim të Komitetit të Investimeve Strategjike Nr.2/13, datë 14/07/2016, me afat 4 (katër) vjeçar. Subjekti është pajisur me Leje Zhvillimore Komplekse Nr. Prot 2385/2 datë 27.04.2015, lëshuar sipas Vendimit Nr.8, datë 07.03.2014, miratur nga KKT, e përditësuar me Lejen e Ndërtimit sipas Vendimit Nr.13. datë 12.04.2017, për "Rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese dhe shtesë në sipërfaqe të Resortit Turistik "Green Coast", me adresë në Palasë, Bashkia Himarë", miratur nga KKT.

PROJEKTE TË REFUZUARA									
1	ADRIATICA HOLDING SHPK Kultivimi i karakalecave	Bujqësi (nënsektori akuakulturi)	4,2 mln Euro 120 vende pune	-	Kultivimi i karakalecave	Karavasta , Divjakë 400 ha	Shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me Vendim KIS Nr. 1/3, datë 19.04.2018	Projekti nuk u miratua pasi bazuar në legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit, atij për zonat e mbrojtura, legjislacionit për vlerësimin e ndikimit në mjedis, specia e përdorur në kultivim është e ndaluar në Evropë, si një specie invazive që shkakton zhdukjen e specieve autoktone.
2	SOUTH COAST DEVELOPMENT "Krorëz Resort"	Investim Shqiptar + i Huaj.	Turizëm Hotel + Vila 110,000,000 euro Punësim 600 vende pune.	-	Krorëz , Shën Vasil	Privat/Shtet -Shtet zonë e azhurnuar 889,567m2 -Shtet zone e pa azhurnuar 498,644m2 -Pronë private 936,666m2	Shtet dhe privat	Procedurë e vecantë Refuzuar me VKIS nr. 13/5 datë 4.03.2019	Kërkesa u refuzua sepse subjekti nuk përmbushte kapacitetet financiare të kërkuara nga ligji.
3	NOVOSELE PHOTOVOLTAIC POËER PLANT Impiant Fotovoltaik Energjitik 50 MËAC, Novoselë	Energji	84.782.706 Euro Punësimi 503-784 vende	-	Impiant gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike	Vlore	Shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 34/2, datë 14/02/2018	Realizimi i parkut fotovoltaike është në mospërputhje me destinacionin e parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor Vlorë, pasi në këtë zonë parashikohet ndërtimi i një aeroporti. Subjekti nuk disponon një autorizim paraprak të vlefshëm, për shkak të përfundimit të afatit të vlefshmerisë 6 muajore të Autorizimit Paraprak (për vazhdimin e procedurës) nga MEI. Subjekti nuk paraqiti asnjë dokumentacion të kërkuar nga ligji, brenda afateve të autorizimit paraprak, të lëshuar nga ministria përgjegjëse për

									energjië, duke humbur automatikisht të drejtën e fituar në përfundim të afateve të percaktuara në miratimin paraprak.
4	Mane TCI Vala Mare II	Turizëm	64,162,910 Euro 200 vende pune	-	Struktura turistike Vila dhe apartamente	Durrës	Privat	Refuzuar me VKIS Nr. 22/2, datë 20/11/2017	Shkak i refuzimit, si mungesë e strukturave akomoduese turistike në projektin Vala Mare II, në përputhje me legjislacionin e turizmit dhe të investimeve strategjike në fuqi.
5	CONCORD INVESTMENT Saranda Marina Resort & Senior Housing	Turizëm	26,125,000 Euro	-	Kompleks turistik	Sarandë	Shtetërore	Refuzuar me VKIS Nr. 26/2, datë 20/11/2017	Projekti është vlerësuar si i pamaturuar. Ky projekt është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Sarandë, pasi kriteret teknike të PPV Sarandë parashikojnë që destinacioni i zonës është rekreacioni/rigjenerimi urban, dhe jo banim e resort që do e shndërronin zonën në territor privat me përdorim të kufizuar.
6	MILLENIUM INTERNATIONAL Poro Vlore	Turizëm	21,081,700 Euro 148 vende pune	-	Kompleks turistik, në sipërfaqe 64 ha	Vlorë	Privat + shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 10/3, datë 05/12/2016	Projektit iu refuzua statusi, për shkak që lidhen me verifikimin e kushteve të ardhshme, pasi legjislacioni i ri për zonat e mbrojtura, i cili do të rregullonte funksionimin e sistemit të zonave të brendshme për zhvillimin e turizmit, ishte në proces hartimi.

7	MABETEX GROUP Divjaka Resort Albania	Turizëm		-		Divjakë	Shtet	Refuzuar me VKIS Nr. 16/3 , datë 4 / 3 /2019	Projekti u refuzua pasi tipologjia e projektit nuk është ne përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e mjedisit dhe atë për zonat e mbrojtura, pasi projekti synon të shtrihet brenda Parkut Kombëtar Divjaka- Karavasta dhe prek Zonë Qendrore, Zonë Kreative dhe Zonë të Përdorimit Tradicional.
8	ADRIATICA HOLDING SHPK Kultivimi i karakalecave	Bujqësi (nënsektori akuakulturi)	4 mln Euro 120 vende pune	-	Kultivimi i karakalecave	Karavasta , Divjakë 400 ha	Shtet	Procedurë e asistuar Refuzuar me Vendim KIS Nr. 18/5, date 01.08.2019	Mospranimi e kërkesës, pasi në referencë të legjislacionit për zonat e mbrojtura, legjislacionit për mbrojtjen e biodiversitetit, legjislacionit për zhvillimin e akuakulturës, specia e kërkuar për t'u përdorur për kultivim është specie invazive dhe tipologjia e projektit nuk përputhet me kriteret e zonës. Subjekti propozues paraqet mungesë të burimeve dhe kapaciteteve financiare, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi.
9	"VORTEK" SH.P.K & BEST DUTY FREE" SH.P.K. Beryl Resort	Turizëm	15.519.970 Euro 165 vende pune	-	1 hotel me 4 yje dhe njësi akomoduese vila dhe apartamente, si dhe ambiente shërbimi, si bare dhe restorante, SPA etj.	Fshati Qerret, Bashkia Kavajë	Shtet	Refuzuar me Vendim KIS / dhjetor 2020	Mospranimi i kërkesës është bërë për shkak se: Referuar 'Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit' si dhe dokumenteve të tjerë në fuqi për planifikimin dhe rregullimin e territorit, modeli i propozuar i projektit të investimit "Beryl" nuk përputhet me modelin e miratuar në këto akte për një zhvillim cilësor të turizmit në përputhje me

									treguesit që zonat me përparësi zhvillim turizmi (ZPZHT) parashikojnë.
10	JONIAN HEAVEN GROUP "Jonian Heaven"	Turizëm	78,000,000 Euro 443 vende pune		Dy hotele respektivisht, me 280 dhoma dhe 84 dhoma, restorante, bare, një kazino, salla konferencash, pishinë, SPA.	Fshati Vrinë, Bashkia Konispol	Privat dhe Shtet	Refuzuar me Vendim KIS / dhjetor 2020	Mospranimi i kërkesës është bërë për shkak se: Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, projekt propozimi është jo i plotë, i pamundur të klasifikohet si "projekt me potencial strategjik" e të konsiderohet një projekt i mundshëm investimi me ndikim strategjik për zhvillimin e vendit dhe me interes publik, në kuptim të parashikimeve të VKM Nr. 1024, datë 16.12.2015 "Për miratimin e projekteve me statusin "Projekt me Potencial Strategjik".



ALBANIAN INVESTMENT DEVELOPMENT AGENCY

invest in Albania



Albanian Investment Development Agency
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve

✉ info@aida.gov.al

🌐 aida.gov.al

☎ +355 (0)42 251 001

🐦 [@investinalbania](https://twitter.com/investinalbania)

📷 [@aida__albania](https://www.instagram.com/aida__albania)

📘 AIDA - Albanian Investment Development Agency

🌐 AIDA - Albanian Investment Development Agency